



STUDIM

KONSUMI I ENERGJISE ELEKTRIKE NE FAMILJE

Tirane Gusht – 2009 –

Permbajtja e Lendes:

HYRJE	4	
KAPITULLI I.		
KONSUMI I ENERGJISE ELEKTRIKE NE FAMILJE	6	
1.1. Ecuria e konsumit te energjise elektrike ne familje 1985-2008	6	
1.2. Sherbimet qe ofrohen nga perdorimi i energjise elektrike per nevoja familjare.	10	
1.3. Struktura sektoriale e konsumit te energjise elektrike.....	13	
1.4. Analiza e struktures se konsumit te energjise elektrike per konsumatoret familjare ne cdo nivel konsumi:	14	
KAPITULLI II.		
STRUKTURA E KONSUMIT FAMILJAR TE ENERGJISE ELEKTRIKE	18	
2.1. Vezhgimi i AKE-se	18	
2.2. Studimi i Decon-it etj.	20	
2.3. Konkluzione nga "Vezhgimi i AKE-se" dhe Studimi i Decon-it.....	23	
KAPITULLI III.		
PARIMET METODOLOGJIKE PER HARTIMIN E STUDIMIT NGA ERE ..	25	
3.1. Politikat energjetike per mbrojtjen e konsumatoreve familjar ne nevoje:.....	27	
3.2. Politikat e derisotme qeveritare per mbrojtjen e familjeve ne nevoje:	27	
3.3. Kategorite perfituese.....	28	
3.4. Percaktimi i vleres se kompensimit financiar:.....	29	
3.5. Skema e subvencionit :	29	
3.6. Kushtezimet per perfitimin e subvencionit me pagesen e konsumit te energjise elektrike:	30	
3.7. Treguesit statistikore te buxhetit familjar per energji elektrike:.....	30	
3.8. Disa perfundime nga mardheniet: "konsumator – te ardhura dhe konsum energjie elektrike"	32	
KAPITULLI IV		
KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME		
ANEKS. -1-		
TEKNIKA E MATJES SE KONSUMIT SPECIFIK TE ENERGJISE ELEKTRIKE:		40
5.1. -Operacionet e matjes se energjise elektrike specifike:.....	41	
5.2. Matja e konsumit specifik per tekniken televizive :	47	
5.3. Matja e konsumit specifik per aksesoret elektroshtepiak :	48	

Lista e Figurave:

Figure 1	Konsumi familjar i energjise elektrike n e fshat, qytet dhe totali (vlerat).....	7
Figure 2	Konsumi familjar i energjise elektrike ne fshat, qytet dhe totali.....	8
Figure 3	Ecuria e konsumit te energjise elektrike per Tiranen, zonen urbane dhe zonen rur.	8
Figure 4	Konsumi i energjise elektrike 1985- 2008	9
Figure 5	Konsumi familjar ne % te Furnizimit	9
Figure 6	Struktura sektoriale e konsumit te energjise elektrike	14
Figure 7	Shperndarja e amonenteve sipas nivelit te konsumit te energjise elektrike.....	17
Figure 8.	Konsumi i energjise elektrike sipas kategorise se perdorimit.....	20
Figure 9.	Konsumi familjar sipas kategorise se perdorimit.....	21
Figure 10	Skema elektrike princiiale e aparatit mates multifunksional	40
Figure 11	Pamje e aparatit mates multifunksional Tip “brennenstuhl” PM-230	41
Figure 12	Matja e Konsumit specific ne nje bojler 80 litra, vertikal.....	42
Figure 13	Matja e konsumit specifik te kompjuterit “Dell”	50

Lista e Tabelave:

Table 1	Konsumi mesatar/familjar per cdo interval.....	15
Table 2	Konsumi mesatar/familjar ne menyre progresive	16
Table 3	Konsumi mesatar mujor sipas zonave (kWh)	18
Table 4	Kerkesa per energji elektrike, pa ngrohje, e nje familje ne vitin 2001	21
Table 5	Kerkesa maksimale per energji elektrike, pa ngrohje, per nje familje ne vitin 2015	22
Table 6	Pesha specifike e energjise elektrike per cdo sherbim ne familje	23
Table 7	Kategorite perfituese te shtresave ne nevoje te subvencionimit nga shteti.....	29
Table 8	Buxheti Mesatar Mujor i Familjes	31
Table 9	Buxheti Mesatar Mujor i Familjes per Energji Elektrike.....	31
Table 10	Konsumi Mesatar Mujor i Energjise Elektrike ne Familje	32
Table 11	Tabela Permbledhese	33
Table 12	Konsumi sipas Regjistrimit te Faturimeve ne O.S.SH viti 2008.....	34
Table 13	Pesha specifike ne %, e energjise per cdo lloj sherbimi ndaj energjise elektrike tot	35
Table 14	Karakteristikat teknike te aparatit mates multimeter	40
Table 15	Karakteristikat teknike dhe rezultatet e matjeve te boliereve per 60°C.....	41
Table 16	Karakteristikat teknike dhe rezultatet e matjeve te boliereve per 90°C.....	42
Table 17	Konsumi per banje me dush i nje personi madhor.....	43
Table 18	Makine Larese “Zannusi” t=60°C.....	44
Table 19	Makine larese “Zannusi”, t=90°C.....	44
Table 20	Frigorifer “Ariston”	45
Table 21	Frigorifer “Obodin”	45
Table 22	Televizor ”Sony”, 29”	46
Table 23	Televizor ”Grundig”, 25”	47
Table 24	Hekur hekurosje “Tefal”	47
Table 25	Furre me mikrovale “Moulinex” -	48
Table 26	Thekse buke “Philips”	48
Table 27	Grill elektrik “Moulinex”	48
Table 28	Fshese elektrike “Primotecq”	49
Table 29	Personal kompjuter “Dell”	49
Table 30	Kondicioner ajri “Mitsubishi “	50

HYRJE

Furnizimi me energji elektrike ne menyre te panderprere i konsumatoreve perfaqeson, duke filluar nga viti 2008, nje risi ne zhvillimin ekonomik-social te vendit. Pa dyshim arritja e nje standarti te tille furnizimi nenkupton edhe nje rritje te kerkeses vjetore per energji elektrike dhe per pasoje edhe shpenzime me te medha per realizimin e ketij standarti.

Enti Rregullator i Energjise, si nje institucion i pavarur, ka detyrimin ligjor mbrojtjen e konsumatorit te energjise elektrike nga efektet negative qe mund te sjelle sistemi monopol i sherbimeve te furnizimit me energji elektrike.

Nje nga instrumentat me efikase per kete qellim eshte ai i kontrollit shteteror mbi cmimet dhe tarifat e energjise elektrike, ne menyre qe ato te jene cmime te rregulluara, cka do te thote te jene cmime qe mbeshteten mbi kostot reale dhe vendosin nje ekuiliber ndaj kerkesave te furnizuesit, duke i garantuar atij mbulimin e shpenzimeve per sherbimin qe kryen si dhe nje fitim te arsyeshem per vazhdimin e veprimtarise dhe realizimin e nje programi te sukseseshem investimesh.

Nga ana tjeter cmimet e rregulluara i garantojne konsumatorit sigurine se ato jane cmime te kontrolluara, te mbrojtura nga abuzimi apo spekulimi i te qenit ne pozicion monopol te furnizuesit, mbasi i tere procesi i vleresimit te cmimeve e tarifave kryhet sipas procedurash transparente per publikun dhe sipas metodologjish shkencore, rigorozisht te percaktuara dhe te bera publike.

Ne menyre te permbledhur mund te thuhet se mbrojtja e konsumatorit nga spekulimet ne cmimet dhe tarifat e energjise elektrike kryhet nepermjet efektit rregullator i cili realizohet nga institucione te pavarura shteterore, qe ne vendin tone perfaqesohen nga ERE.

Duke qen se energjia elektrike si mall, ne kohen e soteme, perfaqson nje produkt te menyres se egzistences se shoqerise njerezore dhe si e tille eshte shume e kerkuar dhe shume e cmuar nga te gjitha kategorite e jetes dhe veprimtarise njerzore, prandaj perdorimi racional dhe me eficience te larte i saje eshte gjithashtu shprehje e veprimit te efektit rregullator.

Ne kete aspekt ERE per te dekurajuar perdorimin e energjise elektrike per ngrohje te baneses dhe per te nxitur perdorimin per kete qellim te lendeve te tjera energjetike, shfrytezon veprimin rregullator d.mth. tarifen e energjise elektrike nga niveli per te cilen ajo perdoret edhe per ngrohje, e vendos te diferencuar nga tarifa e pjeses tjeter te energjise. Ne kete menyre realizohet sistemi tarifor me dy ose me teper blloqe konsumi.

Nje dukuri tjeter qe lidhet me cmimet dhe tarifat e nergjise elektrike jane efektet sociale qe shkaktojne ato mbi shtresat e ndryshme te popullsise. Sikurse dihet, ne vendin tone, por jo vetem, egziston nje shtrese e popullsise me te ardhura te pakta, te pamjaftueshme per te perballuar pagesen e fatures se energjise elektrike.

Mbrojtja sociale e konsumatoreve te energjise elektrike ne nevoje, nuk eshte detyrim ligjor i ERE-s, por trajtohet nga strukturat e Qeverise dhe pikerisht nga Ministria e Punes Perkrahes Sociale dhe Shanseve te Barabarta. Megjithate ERE

bashkepunon me kete institucion per te marre te gjithë informacionin e nevojshem qe lidhet me trajtimin e kesaj kategorie shoqerore ne menyre qe ne rastin e vleresimit te tarifave te energjise elektrike me blloqe konsumi, te behet e mundur analiza edhe per kete shtrese te popullsisë.

Krahas kesaj per Entin Rregullator te Sektorit te Energjise (ERE) eshte me shume rendesi struktura e konsumit te energjise elektrike nga kategorite e ndryshme te konsumatoreve. Nje gje e tille, eshte akoma me e rendesishme per konsumatorët familjare, te cilet konsumojne aktualisht rreth 55 % te gjithë energjise elektrike te faturuar ne vend.

Duke qene se cmimet dhe tarifat e energjise elektrike te vendosura nga ERE per vitin 2008 parashikojne per konsumatorët familjare tarifim me dy blloqe konsumi, merr rendesi te madhe, vleresimi i sasise se energjise elektrike per bllokun e pare, ose per bllokun me tarife me te ulet.

Sikurse dihet, ERE ka vendosur konsumin per bllokun e pare ne masen 300kWh ne muaj, me tarife 7 lek/kWh, kurse per konsumin mbi 300 kWh ne muaj, me tarife 12 lek/kWh, si shprehje te politikës rregullatore per dekurajimin e ngrohjes se baneses me energji elektrike.

Blloku me konsum 300 kWh/muaj eshte perdorur se pari ne vitin 2003. Me pas u kalua ne Bllokun me 210 kWh/Muaj dhe ne vitin 2008 u kalua perseri ne ate me 300 kWh/muaj

Per vleresimin e madhësisë se kufirit te poshtem te konsumit mujor te energjise elektrike ose sic perdoret te "Bllokut te Pare" eshte kryer ne vitet 2002 – 2003 nje survejim nga Agjensija Kombetare e Energjise me financim te Bankes Boterore, por duhet te theksojme se nuk egzistonin te dhena te mjaftueshme nga pikpamja e politikave qeveritare te perkrahjes sociale per shtresat ne nevoje po ashtu dhe te dhena per analizen e struktures se konsumit te energjise elektrike per konsumatorët familjare.

Ne vitin 2008 vleresimi i kufirit te poshtem te konsumit mujor te energjise elektrike u kushtezua nga ai nivel per te cilin nuk perdoret ngrohje e baneses. Ky nivel sikurse konfirmohet edhe nga studimi i AKE-se te vitit 2003 u pranua ne sasine prej 300kWh/muaj dhe brenda tij u trajtua edhe shtresa ne nevoje e popullsisë, me nje politike te re mbeshtetese nga ana e Ministrise se Punes e Perkrähjes Sociale si dhe sigurimi i te ardhurave te mjaftueshme per KESH-in ne perputhje me analizen e bilancit te saje te te ardhurave dhe shpenzimeve.

Studimi i tanishem, i ndermare nga ERE, ka analizuar gjithë trashëgimine studimore te vendit tone ne kete fushe dhe ka per qellim qe te vleresoje madhësinë e kufirit te poshtem te konsumit mujor te energjise elektrike mbi bazen e nje seti te ri te dhenash te struktures se konsumit te energjise elektrike nga konsumatore familjare si dhe te politikës se Qeverise per mbeshtetjen e familjeve me te ardhura te pakta nga ndikimi financiar i rritjes se cmimit te energjise elektrike. Trajtimi i problemit nga nje kendveshtrim i ri dhe mbi nje baze te re te dhenash mendojme se eshte nje kontribut sado modest ne perligjjen e argumentuar te kufirit te "Bllokut te Pare".

KAPITULLI I .

KONSUMI I ENERGJISE ELEKTRIKE NE FAMILJE

Objekt analize i ketij studimi eshte konsumi i energjise elektrike ne familje. Ne kete kuader ai do te trajtohet ne disa aspekte, se pari:

- Ne kend-veshtrimin historik te ecurise se tije, qe nga viti 1985 dhe deri ne vitin 2008.
- Ne sherbimet qe ofron per perdorim shtepiak.
- Ne raport me strukturen e konsumit te energjise elektrike me sektoret e tjere te ekonomise dhe te jetes sociale.
- Ne raport me strukturen e konsumit per cdo nivel konsumi.

1.1. Ecuria e konsumit te energjise elektrike ne familje 1985-2008

Ne Shqiperi ecuria e konsumit familjar te energjise elektrike ka nje zhvillim tipik dhe mjaft karakteristik, qe lidhet ne radhe te pare me ndryshimin dramatik te struktures se pergjitheshme te konsumit te energjise elektrike nga sektoret e ndryshem te jetes ekonomiko-sociale te vendit, si industria, bujqesia, sherbimet etj.

Ky ndryshim shperthyes u kushtezua para se gjithash nga ndryshimi i sistemit politik, i cili solli si pasoje permbyshjen e struktures egzistuese te konsumit te energjise elektrike ne vitet 1991-92.

Ne vitet 2002-2003, me financim te Bankes Boterore, kompanite e njohura nderkombetare, Decon, EDF, Lehmeyer, LDK dhe GEI-Energy kryen nje studim te titulluar "Projekti i transmetimit dhe i shperndarjes se energjise elektrike ne Shqiperi", i cili per nga natyra e tij eshte unikal, mbasi rrok ne nje analize te hollesishme te gjithe sektoret e gjenerimit, transmetimit, shperndarjes dhe konsumit te energjise elektrike dhe ne kete kuader nje vend me rendesi ze edhe konsumi familjar i energjise elektrike.

Sipas studimit te Decon-it etj. per periudhen 1985-2001 dhe plotesimit nga ana e ERE-s te periudhes 2001-2008 jane ndertuar grafiket qe shprehin ecurine e konsumit familjar te energjise elektrike per periudhen 1985-2008.

Ne qofte se gjate periudhes 1985 – 1991 rritja mesatare e konsumit familjar te energjise elektrike kishte nje gradient prej 24 GWh/Vit, (nga 193.1 GWh ne vitin 1985 ne 402.1 GWh, ne vitin 1991), gjate periudhes 1991 – 2001 ky gradient u rrit ne 194 GWh/Vit, ose me nje intensitet 8 here me te madh. Kjo rritje shperthyese e konsumit familjar te energjise elektrike nga 402.1 GWh ne vitin 1991 ne 2339.4 GWh ne vitin 2001 u shoqerua me nje numur te madh problemesh ne sistemin e furnizimit me

energji elektrike, i cili nuk ishte ne gjendje te perballonte teknikisht keto transformime te paimagjinueshme.

Ne studimin e Decon etj. i behet nje analize e hollesishme faktoreve qe cuan ne rritjen e jashtezakoneshme te konsumit te energjise elektrike ne familje. Keshtu mund te permenden si me tipike: urija e madhe e popullates per pajisje elektroshtepiake te nevojës se pare si frigorifere, makina larese, pajisje audiovizive, ngrohës uji elektrik etj. mbasi per shkak te izolimit te pergjithshem te vendit nga regjimi totalitar dhe nivelit te ulet te te ardhurave per familje, per keto pajisje kishte nje mungese te madhe. Nga ana tjeter, cmimi i ulet i energjise elektrike, vjedhjet e saje, arketimet e uleta dhe ne keto rethana perdorimi ne shkalle te gjere i energjise elektrike per ngrohje banese, ishin faktor qe e persheptuan ne limitet e skajshme kerkesen per energji elektrike nga konsumatorët familjare.

Ne grafikun e Figures -1- eshte paraqitur ecurija e konsumit familjar te energjise elektrike nga konsumatorët e fshatit, te qytetit si dhe totali i tyre, te shprehura ne vlera numerike, perkatesisht per cdo vit, kurse ne figuren -2- eshte paraqitur i njejti grafik ne nje forme qe evidenton me qarte ligjshmerine e ndryshimit te kerkeses per energji elektrike per keta konsumatore per periudhen 1985 – 2008.

Burimi: Studimi Decon dhe ERE)




Figura 1. Konsumi familjar i energjise elektrike nga konsumatorët e fshatit, te qytetit si dhe totali (vlerat).




Figura 2. Konsumi familjar i energjise elektrike nga konsumatoret e fshatit, te qytetit si dhe totali

Nga analiza qe i behet te dhenave rezulton se gradienti i rritjes se kerkeses per energji elektrike te konsumatoreve te zonave urbane eshte 81% me i larte se gradienti i kesaj rritjeje per zonat rurale (perkatesisht 124.9 GWh/Vit dhe 68.8 GWh/Vit).

(Burimi: Decon)




Figura 3. Ecuria e konsumit te energjise elektrike per Tiranen, zonen urbane dhe zonen rurale te vendit.

Ne figuren -3- jane ilustruar ne menyre grafike, sipas te dhenave te studimit te Decon-it tempet e ndryshimit te konsumit familjar te energjise elektrike per Tiranen, fshatin dhe qytetetet e tjera te vendit.

Gjate periudhes 2001 – 2008 verehet nje stanjacion i rritjes se kerkeses per energji elektrike per te dyja kategorite e konsumatoreve familjare.




Figura 4. Konsumi i energjise elektrike 1985- 2008

Nje karakteristike specifike e struktures sektoriale te konsumit te energjise elektrike ne vendin tone eshte fakti se gjate periudhes 1985 – 1991 konsumi familjar zinte vetem (8 – 10)% te furnizimit te vendit me energji elektrike.

(Burimi ERE)




Figura 5. Konsumi familjar ne % te Furnizimit

Ne figuren -4- eshte shprehur grafikisht ecuria e furnizimit te vendit me energji elektrike dhe ecuria e konsumit familjar te energjise elektrike per periudhen 1985 - 2008, ndersa ne figuren -5.- eshte paraqitur grafikisht raporti i konsumit familjar te energjise elektrike ndaj energjise se pergjitheshme te furnizuar, shprehur ne perqindje te kesaj te fundit. Ne se do ti referoheshim energjise elektrike te pergjitheshme te

faturuar d.m.th energjise se pergjitheshme te furnizuar por pa humbjet totale atehere energjia elektrike e konsumit familjar aktualisht perben rreth 57% te energjise elektrike te faturuar.

1.2. Sherbimet qe ofrohen nga perdorimi i energjise elektrike per nevoja familjare.

Sherbimet qe ofrohen nga ana e energjise elektrike dhe kane gjetur perdorim per plotesimin e nevojave ne familjet e vendit tone mund te themi se jane te njejta me ato qe perdoren edhe ne vendet e zhvilluara te Evropes dhe te botes. Edhe ne vendin tone perdorimi familjar i energjise elektrike sikunder edhe ne vendet e zhvilluara te botes eshte menyre egzistence, ajo sherben njekohesisht per plotesimin e nevojave jetike si dhe te nevojave te tjera socialkulturore. Me poshte paraqiten fushat e perdorimit te energjise elektrike ne familjet tona si dhe disa tregues specifik qe percaktojne dhe nje fare individualiteti te natyres se ketij perdorimi.

a. Per ndricimin elektrik te baneses.

Ne Shqiperi 100% e familjeve ne qytet dhe ne fshat ndricohen me energji elektrike. Pergjithesisht konsumi i energjise elektrike per ndicim eshte me i madh se ne vendet e zhvilluara te Evropes. Arsyet e nje dukurije te tille mendojme se kane te bejne:

- Me penetrimin ne shkalle te ulet per ndricim, te llampave fluoreshente kompakte me eficence te larte, ne vend te llampave inkandenshente me rendiment te ulet.
- Me perdorimin e aparateve ndricues me numur te madh llampash dhe te mungeses se komandimit te pjeseshem te tyre.
- Me perdorimin e nje numuri te madh ndricuesish per ndricimin e jashtem te baneses individuale jo vetem per qellime sigurije por edhe per nje lloj mentaliteti ekzibicionist.

b. - Per gatim familjar

Sipas studimit te Decon-it etj. deri ne vitin 2001, 80 % e familjeve gatuanin me energji elektrike. Kemi mendimin se ne ditet e sotme per shkak te penetrimit me te madh te gazit te lenget (GPL) si dhe te rritjes se cmimit te energjise elektrike duhet te kete nje fare reduktimi te ketij perdorimi. Per fat te keq nuk disponohen te dhena korente per te perligjur nje hipoteze te tille.

Gatimi pergjithesisht kryhet ne soba elektrike dhe soba te kombinuara me gaz dhe energji elektrike per gatim dhe pothuaj se ne 100 % te rasteve, furrat pjekese te sobave funksionojne me energji elektrike.

c. - Per uje te ngrohje sanitar

Ne zonat urbane, 95% e ngrohjes se ujit per nevoja sanitare ne familje kryhet me ngrohesa elektrik (bojler elektrik) te standardizuar. Ne zonat rurale kjo metode perdoret ne nje shkalle me te vogel. Ne vitin 2001 ajo eshte vleresuar rreth 40%, kurse ne ditet e sotme mendojme se eshte me e madhe.

Mungesa e sistemeve te ngrohjes se centralizuar te baneses ka bere qe te perdoret me shume metoda e decentralizuar e ngrohjes se ujit sanitar, e cila realizohet me nje shkalle eficiencie me te ulet pra me nje shpenzim me te madh energjie elektrike.

Edhe shkalla e penetrimit te paneleve diellore termike per uje te ngrohje sanitar eshte aktualisht shume e ulet dhe nepermjet tyre perftohet vetem 1 – 1.5 % e energjise se pergjitheshme qe perdoret per ngrohje uji.

Ne zonat rurale perdoren edhe menytrat e thjeshta te ngrohjes se ujit sanitar me dru zjarri.

d. – Per ngrohjen e baneses.

Pervetesimi ose marrja e paligjeshme e energjise elektrike, perdorimi i saje nga rreth 10% e konsumatoreve familjare pa matesa, por me te ashtuqajturin "Faturim aforfe" si dhe cmimet ende relativisht te uleta te energjise elektrike per konsumatorët familjare, jane faktore me rendesi qe inkurajojne perdorimin e energjise elektrike per ngrohje te baneses.

Ngrohja kryhet ne menyre te decentralizuar per cdo familje. Si pajisje ngrohese perdoren aparate ngrohese me rezistenca nikel-krom ose me elektroda kuarci (reflektore) ne ajer apo ne radiator me vaj, me emetim me radiacion dhe konveksion ose dhe qarkullim te detyruar ajri. Keta aparate ngrohese pervec se perfaqesojne sistem te decentralizuar ngrohje me eficiencie te ulet, jane nga ana tjeter ne vetevehte edhe pajisje me rendiment te ulet termik. Perdorimi edhe per ngrohje i pompave te nxehtesise (kondicionereve) qe kane rendiment termik me te larte eshte i kufizuar, per shkak te koston se tyre.

Nje tipar karakteristik i kesaj menyre ngrohese te baneses eshte ngrohja e pjeseshme e saje dhe jo ngrohja teresore sikurse realizohet me sistemet e perqendruara.

e. – Per freskimin e baneses.

Kushtet klimatike te vendit tone, me vere shume te nxehte dhe te thate, kane bere qe vitet e fundit te marre nje perdorim mjaft te madh perdorimi shtepiak i kondicionereve per freskim te baneses. Deri ne vitin 2001 perhapja e tyre ka qene e

kufizuar per shkak te cmimeve te larta dhe trajtimi i tyre ne studimin e Decon-it etj. pothuajse eshte neglizhuar. Ne kushtet aktuale kur cmimet e tyre jane reduktuar ne krahasim me vitin 2001 rreth 200%, prania e tyre ndikon ne riprofilimin e grafikut te ngarkeses per stinen e veres, me nje rritje rreth 20% te konsumit ditor te energjise elektrike ne shkalle vendi, ndaj konsumit ditor te vitit 2001. Sot kondicioneret perbejne nje faktor me ndikim ne analizen e konsumit familjar te energjise elektrike. Nga ana tjeter ne gjykimin tone ata nuk mund te trajtohen si pajisje konforti shtepijak, por ne te kunderten ne mendojme se ata perfaqsojne pajisje te nevojshme dhe si te tilla do te merren ne konsiderate ne kete studim, por jo per familjet ne nevoje.

f. - Per ruajtjen e produkteve ushqimore me tekniken e ftohjes.

Kjo teknike ftohese realizohet me anen e frigorifereve familjar me kapacitete te ndryshme. Aktualisht 100% e familjeve jane te pajisur me frigorifer ne zonat urbane dhe rreth 95% ne ato rurale.

Frigoriferet e vene ne perdorim mbas vitit 2001 kane tregues me te mire te eficiences se perdorimit te energjise elektrike.

Klima e vendit ndikon ne energjine e konsumuar, gjate stines se veres, per shkak te temperaturave te larta te stines, ka nje rritje deri ne 20% te konsumit te energjise elektrike.

g. - Per larjen e rrobave me makine larese.

Sot ne zonat urbane vetem me ndonje perjashtim te vogel, 100 % e familjeve perdorin per larjen e rrobave makinat larese elektrike te tipeve dhe kapaciteteve te ndryshme, ndersa ne zonen rurale perdorimi i tyre shtrihet ne masen deri ne 70%. Kufizimi i perdorimit me te madh ne zonat rurale lidhet me kapacitetet ende te limituara te rrjeteve te furnizimit me uje te rrjedhshem ne keto zona.

h. - Per informimin dhe edukimin viziv me televizion.

Sot, pothuajse 100% e familjeve shqiptare, perdorin per informim dhe edukim kulturor e zbavitje televizorin me ngjyra te tipeve dhe madhesive te ndryshme. Karakteristik eshte fakti se ne Tirane mbi 40% e familjeve perdorin dy e me shume televizore ne familje, kurse ne zonen tjeter urbane te vendit numuri i tyre arrin ne rreth 20% te familjeve.

Ne sistemet e integruara audiovizive ne vendin tone perdoren ne shkalle te gjere edhe marresit satelitore dhe video-sistemet. Per Tiranen keto sisteme te integruara perdoren nga rreth 50% e familjeve kurse ne zonat e tjera urbane dhe rurale ato perdoren nga rreth 35% e familjeve.

i. – Per mjediset e perbashketa ne pallatet e banimit me disa apartamente.

Ne kete kategori sherbimi ben pjese ndricimi elektrik i shkalleve, furnizimi me energji elektrike i ashensoreve, i pompave te perbashketa te ujit etj.

j. – Per pajisje te tjera.

Ne kete grup pajisjesh elektroshtepijake bejne pjese:

- Hekuri per hekurosje teshash
- Ventilatorete per freskim mjedisi.
- Fshesat elektrike.
- Furrat me mikrovale.
- Thareset elektrike te flokeve.
- Ekspreset e kafese.
- Kombinati i kuzhines.
- Brumatricet elektrike familjare (makina e bukes).
- Pajisjet per thekjen e bukes.
- Tostet per hamburger.
- Jasteket dhe jorganet termo-elektrik.

Shenim: Te dhenat mbi shkallen e perdorimit te pajisjeve elektroshtepiake ne shkalle vendi jane nxjerre nga studimi i Decon-it duke bere dhe disa korektime nga burime te tjera.

1.3. Struktura sektoriale e konsumit te energjise elektrike.

Deri ne vitin 1991 struktura e konsumit te energjise elektrike ka qene e predominuar nga konsumi industrial, nga konsumi per sherbimet publike dhe tregtare si dhe per bujqesine. Konsumi familjar zinte vetem 8-10% te konsumit te pergjithshem te energjise elektrike ne vend. Mbas vitit 1991 predominues behet konsumi familjar ndersa konsumi industrial dhe ai bujqesor pesojne nje reduktim te thelle. Konsumi per sherbimet publike dhe tregtare peson nje rigjallerim dhe nje tendence rritjeje ndonese me disa luhajte gjate periudhes 1997-2003




Figura 6. Struktura sektoriale e konsumit te energjise elektrike

Ne grafikun e figures -6- eshte shprehur marredhenia ndermjet konsumit te pergjithshem te energjise elektrike dhe konsumit familjar per periudhen 1985 – 2008. Ne varesi te te dhenave te ketij grafiku eshte percaktuar ne perqindje madhesija e konsumit familjar kundrejt furnizimit te pergjithshem te energjise elektrike, per te njejten periudhe. Kjo mardhenie ne forme grafike eshte paraqitur ne figuren -5-

Aktualisht konsumi familjar i energjise elektrike ze rreth 36% te konsumit te pergjithshem. Duhet te theksojme se humbjet jo teknike te energjise elektrike jane ne pjesen me te madhe (rreth 60%) si pjese e konsumit familjar.

1.4. Analiza e struktures se konsumit te energjise elektrike per konsumatoret familjare ne cdo nivel konsumi:

Kjo analize eshte kryer duke ju referuar te dhenave te faturimit te energjise elektrike nga ana e DSh (Drejtoria e Shitjeve) te OSSH-es per vitin 2008.

Duke qen se faturimet e Zones se Shperndarjes se OSSH-es per Gjirokastrin nuk jane te perfshira ende ne faturimin elektronik qe kryhet per te gjitha zonat e tjera te vendit, analiza e konsumit te energjise elektrike per konsumatoret familjar te kesaj zone, per pamundesi te detajimit te te dhenave eshte lene jashte kesaj analize.

Per vitin 2008 konsumi i faturuar i energjise elektrike per konsumatoret familjar ne kete zone perben vetem 5.27% te gjithe energjise elektrike te faturuar per konsumatoret familjare ne shkalle vendi, ndersa numuri i konsumatoreve familjare per kete zone ishte vetem 5.9% e te gjithe numurit te konsumatoreve familjare, ne shkalle vendi.

Duke marre ne konsiderate keto te dhena eshte gjykuar e arsyeshme se analiza e struktures se konsumit te energjise elektrike per konsumatoret familjare, duke mos

marre parasysh konsumatorët familjare të zonës së Gjirokastrës, e ka saktësinë e mjaftueshme për të arritur në përfundime të drejta për karakterin e këtij studimi.

Në tabelën -1- janë paraqitur dhe evidentuar të dhënat mbi strukturën e konsumit të energjisë elektrike nga konsumatorët familjare për vitin 2008.

Duke shqyrtuar të dhënat e kësaj table të terheq vëmendjen fakti që 181,291 konsumatorë familjare ose 21.3% e numrit të përgjithshëm të tyre nuk kanë fare konsum mujor. Një gjë e tillë shpjegohet me faktin se të njëjtët konsumatorë mund të kenë dy banesa, një verore të cilën e shfrytëzojnë periodikisht për pushime dhe tjetren për banim, po ashtu është evidentuar një numër i konsiderueshëm banesash të pabanueshme, të rrenuara, por që nuk janë evidentuar në regjistrin e faturimeve si dhe banesa të emigrantëve, të mbyllura dhe pa konsum energjie.

Një dukuri tjetër ka të bëjë me konsumin faktik të energjisë elektrike nga konsumatorët familjare, i cili është i ndryshëm nga konsumi i faturuar dhe kjo për dy arsye:

- Se pari konsumi faktik përbehet nga konsumi i faturuar plus humbjet jo teknike të energjisë elektrike, humbje që shkaktohen nga përvetësimi i energjisë kryesisht nga konsumatorët familjare në tension të ulët.

Tabela-1.- Konsumi mesatar/familjar për çdo interval

Intervali i konsumit	Numri i konsumatorëve familjare për çdo interval konsumi		Energjia e faturuar për çdo interval		Energjia e faturuar në mënyrë progresive		Konsumi mesatar/familjar për çdo interval
	kWh/Muaj	Konsumatorë	% të Tot.	kWh/Muaj	% të Tot.	kWh/Muaj	
0	181,291	21.3	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
1 – 100	128,627	15.1	106,631,572	4.9	106,631,572	4.9	69.1
101-200	189,048	22.2	352,335,434	16.1	458,967,006	21.0	155.3
201-250	73,983	8.7	203,378,238	9.2	662,345,244	30.3	229.1
251-300	81,388	9.5	280,421,174	12.8	942,766,418	43.1	287.1
301-400	85,820	10.1	372,729,455	17.0	1,315,495,873	60.1	361.9
401-500	44,450	5.2	245,624,134	11.2	1,561,120,007	71.3	460.5
501-600	31,468	3.7	213,728,469	9.8	1,774,848,476	81.1	566.0

> 600	36,286	4.3	413,284,925	18.9	2,188,133,401	100	949.1
Totali	852,361	100	2,188,133,401	100	2,188,133,401	100	213.9

(Burimi: Te dhena nga "DSh" OSSH)

- Se dyti energjia elektrike e faturuar ne menyre aforfe eshte e ndryshme nga energjia elektrike konsumuar realisht nga kjo kategori konsumatoresh.

Duke qene se nuk disponohen tregues qe te evidentojne shperndarjen e energjise se pafaturuar ne grupet e konsumatoreve sipas intervaleve te konsumit, do t'i referohemi vetem treguesit te konsumit specifik mesatar te nje konsumatori sipas energjise se faturuar, qe sikurse shihet nga tabela-1- rezulton 213.9 kWh/Muaj. Ne se do te perjashtonim 181,291 konsumatoret me konsum mujor zero, atehere konsumi mesatar specifik i nje konsumatori do te rezultonte 271.7 kWh/Muaj.

Konsumi mesatar faktik, qe merr ne konsiderat edhe energjine ne formen e humbjeve jo teknike, rezulton 365.9 kWh/Muaj (mbasi humbjet jo teknike per vitin 2008 jane vleresuar me 759 GWh).

Duke perjashtuar kontigjentin e konsumatoreve me konsum zero dhe duke ju referuar energjise elektrike te faturuar, nga te dhenat e tabelës-2-, verehet se 473,046 abonente konsumojne deri ne 300 kWh/muaj, qe perbejne 55.5 % te numrit te pergjithshem te konsumatoreve familjare.

Energjia deri ne 250 kWh/Muaj, konsumohet nga 391,658 konsumatore familjare, ose nga 46.0 % e numrit te pergjithshem te konsumatoreve, ndersa energjia deri ne 200 kWh/Muaj konsumohet nga 317,675 konsumatore familjare ose nga 37.3 % e numrit te pergjithshem te konsumatoreve.

Tabela-2- Konsumi mesatar/familjar ne menyre progresive

Intervali i konsumit	Numuri i konsumatoreve familjare per cdo interval konsumi		Numuri i konsumatorevefamilj are ne menyre progresive		Konsumi mesatar/familj per cdo interval	Konsumi mesatar/familj ne menyre progresive
	Konsumatore	% te Tot.	Konsumatore	% te Tot.	kWh/Muaj	kWh/Muaj
0	181,291	21.3	181,291	21.3	0.0	0.0
1 – 100	128,627	15.1	309,918	36.4	69.1	69.1
101-200	189,048	22.2	498,966	58.5	155.3	76.6
201-250	73,983	8.7	572,949	67.2	229.1	96.3

251-300	81,388	9.5	654,377	76.8	287.1	120.1
301-400	85,820	10.1	740,197	86.8	361.9	148.1
401-500	44,450	5.2	784,647	92.1	460.5	165.8
501-600	31,468	3.7	816,115	95.7	566.0	181.2
> 600	36,286	4.3	852,361	100	949.1	213.9
Totali	852,361	100	852,361	100	271.7	271.7

(Burimi: "DSh",OSSH)

Gjykojme qe konsumatorët familjar me te ardhura me te pakta, jane me te perkore ne perdorimin e energjise elektrike, mbasi mundesite e tyre financiare nuk i lejojne qe ta shpenzojne energjine elektrike per te mbuluar te gjitha nevojat per nje konfort modern, prandaj logjikisht kemi arsyetuar se kategoria e konsumatoreve me te ardhura te pakta duhet te beje pjese ne nivelin e konsumit familjar te energjise elektrike deri 200 kWh/muaj.




Figura 7. Shperndarja e konsumatoreve sipas nivelit te konsumit ne %

Ne figuren-7- eshte paraqitur grafikisht shperndarja ne perqindje e numrit te konsumatoreve sipas niveleve te konsumit.

KAPITULLI II.

STRUKTURA E KONSUMIT FAMILJAR TE ENERGJISE ELEKTRIKE

1.5. Vezhgimi i AKE-se

Gjate periudhes 2002 – 2003 Agjensia Kombetare e Energjise, me financim te Bankes Boterore ka kryer nje vezhgim te specializuar duke intervistuar nje numur prej 1660 subjektsh familjare ne 3 zona urbane qe perfshinin qytetet Tirane, Shkoder dhe Korce dhe ne 3 zona rurale qe perfaqsonin fshatrat Maqellare te Dibres, Gose te Kavajes dhe Borsh te Sarandes.

Per grumbullimin e te dhenave u shfrytezua nje pyetsor me 41 grupe pyetjesh te karakterit te pergjithshem dhe specifik lidhur me burimet e te ardhurave, kushtet e baneses dhe instalimeve, lendet energjetike ne pedorim, sasine e energjise elektrike per ndricim, audiovizion, TV, gatim, uje te ngrohje sanitar, ngrohje banese etj.

Qellimi i ketij vezhgimi ishte, pervec te tjerash, te percaktonte strukturen e konsumit familjar te energjise elektrike, qe do te thote se sa energji elektrike konsumohej nga cdo familje ne kryeqytet, ne zonen tjeter urbane te vendit si dhe ne zonen rurale, per cdo sherbim te ofruar nga energjia elektrike ne familje.

Tabela-3- **Konsumi mesatar mujor sipas zonave (kWh)**

Zonat	Zona urbane					Zona rurale					Mesat Vendi
	Tiran	Shkod	Korce	Mesataria		Maq.	Gose	Borsh	Mesataria		
				kWh	%				kWh	%	
Ndricim	32.0	30.3	30.4	30.9	7.2	25.5	27.2	26.3	26.3	7.4	28.1
Radio,TV, Magnetofon, Lavatrice	74.4	68.7	66.0	69.7	16.1	51.0	57.5	55.4	54.6	15.3	62.1
Gatim	115.4	116.0	117.8	116.4	26.9	83.5	83.1	80.4	82.4	23.1	99.4
Ujei ngrohje sanitar	92.6	90.8	80.8	88.1	20.4	63.3	74.1	69.1	68.8	19.3	78.5
Ngrohje banese	90.6	118.7	170.25	126.5	29.3	160.3	100.5	82.3	114.4	32.0	120.5

Totali Mujor	405.0	425	462	431.6	--	384	342	314	357	--	386
Totali vjetor	4860	5095	5539	5165	--	4603	4108	3763	4287	--	4637
Totali mujor pa ngrohje dhe uje te ngrohje	222	215	211	216	--	160	168	162	163	--	187
Totali vjetor pa ngrohje dhe uje te ngrohje	2662	2581	2526	2590	--	1920	2013	1946	1953	--	2249

(Burimi: Studimi AKE; B.B.)

Per fat te keq, qe nga viti 2001 nuk eshte ndermare ndonje studim tjetër serioz per vleresimin e struktures se konsumit te energjise elektrike ne familje.

Ne tabelen -3- ne menyre te permblledhur eshte paraqitur konsumi mesatar mujor i energjise elektrike sipas zonave te marre ne analize per disa nga sherbimet e furnizimit familjar me energji elektrike.

Si konkluzion i rendesishem i studimit u konsiderua vleresimi i bllokut te pare te konsumit te energjise elektrike nga pikpamja konceptuale si energjia minimale e domozdoshme per te plotesuar nevojat jetesore me energji elektrike per familjet ne nevoje. Ne kete kontekst, mbeshtetur ne rezultatet e studimit te kryer u propozua qe niveli i konsumit per bllokun e pare te jete 220 kWh/muaj me cmim 4.7 lek/kWh, kurse per konsum mbi 220 kWh/muaj, cmimi te jete 10 lek/kWh (pa TVSH).

Nga ana e hartuesve te vezhgimit jane konsideruar si nevoja jetesore per te cilat vleresohet sasija e energjise elektrike per plotesimin e tyre ne dobi te familjeve me te ardhura te pakta energjia elektrike per:

- Gatim
- Ndricim
- Larje teshash me makine larese
- Informacion (audiovizion)
- Ruajtjen e ushqimeve me frigorifer

Te gjitha sherbimet e tjera qe ofrohen nga energjia elektrike per plotesimin e nevojave familjare nuk konsiderohen si nevoja jetesore dhe per pasoje nuk jane marre ne konsiderate ne vleresimin e sasise se energjise elektrike te bllokut te pare.

Nje konkluzion tjetër i rendesishem qe eshte arritur nga ky vezhgim eshte edhe percaktimi i 300 kWhmuaj si sasi e energjise elektrike minimale, mbi te cilen fillon perdorimi i saje per ngrohjen e baneses.

Mendojme se nga pikpamja permbajtesore dhe sasiore ka difference ndermjet konceptit te sasise minimale te energjise elektrike per te plotesuar nevojat me jetesore me kete lloj energjie te familjeve ne nevoje dhe konceptit te sasise minimale te

energji se per rritjen e racionalitetit dhe efienes duke dekurajuar perdorimin e saje per ngrohje.

1.6. Studimi i Decon-it etj.

Nje analize serioze e struktures se konsumit te energjise elektrike sipas llojeve te sherbimit te ofruar prej saje eshte kryer edhe nga grupi i Decon-it e Co.

Nepermjet ketij studimi eshte bere vleresimi i nevojave per energji elektrike te konsumatoreve familjar duke perjashtuar perdorimin e energjise elektrike per ngrohje.

Nga pikpamja metodologjike studimi eshte kryer me dy metoda kryesore:

- Ne percaktimin e ketyre nevojave sipas te dhenave te nje vezhgimi me nje numer te madh te intervistuarish ne Tirane, ne zonat e tjera urbane te vendit dhe ne zonat rurale per vitin 2001 dhe prognozimi per vitin 2015.
- Matematikisht nepermjet perpunimit statistikor te te dhenave me metoden e regresionit duke analizuar ndikimin e nevojave per energji elektrike te konsumatoreve familjare nga te ardhurat familjare, cmimi i energjise elektrike, humbjet jo teknike, efienca e arketimeve, konsumi ne periudhen e mepareshme etj.

(Burimi: Studimi Deconit)




Figura 8. Konsumi i energjise elektrike sipas kategorise se perdorimit

Ne figuren -8- ne menyre grafike jane paraqitur kerkesat e konsumatoreve familjar per energji elektrike per gatim, per uje te ngrohje sanitar, per nevojat e tjera pa perfshire ngrohjen e baneses,si dhe per ngrohjen e baneses dhe totali i te gjithave. Ne figuren -9- paraqitja grafike eshte bere pa vlerat perkatese per nje perceptim vizual me te qarte.

Nga pikpamja konceptuale nepermjet studimit te Decon-it nuk percaktohet sasia e energjise elektrike per plotesimin e nevojave jetesore te shtresave ne nevoje por percaktohet kerkesa normale per energji elektrike, duke perjashtuar ngrohjen e baneses dhe ujin e ngrohje sanitar per nje familje, ne Tirane, ne zonat e tjera urbane dhe ne fshat duke marre ne konsiderate kontekstin konkret te vendit tone nepermjet korektimeve me metoden e analizës statistikore te regresionit.

Ne kete veshtrim sasia minimale e energjise elektrike per shtresat ne nevoje nga pikpamja metodologjike duhet te analizohet nga kriteret e tjera te cilat kane te bejne me vleresime social-ekonomike dhe politika qeveritare mbrojtese per kete kategori konsumatorësh.

(Burimi: Studimi Deconit)




Figura 9. Konsumi familjar sipas kategorise se perdorimit

Rezultatet e studimit te Decon-it ne menyre te permbledhur jane paraqitur ne tabelen -4- dhe i referohen vitit 2001.

Tabela -4- Kerkesa per energji elektrike, pa ngrohje, e nje familje ne vitin 2001

Lloji i Sherbimit	Konsumi ne zonat qe analizohen ne kWh/muaj		
	Tirana	Zonat e tjera urbane	Zonat rurale
Ndricim elektrik	59	50	45
Ftohje me frigorifer	62	61	49
Informacion me TV&Video	22	21	20
Informacion me marres satelit	3	7	7
Larje teshash me makine larese	45	30	20
Konsum ne mjediset e perbasheta	15	12	3
Informacion me sistem audio	20	15	10

Hekurosje teshash	10	10	7
Freskim me ventilator	10	10	5
Pastrim me fshese elektrike	7	7	3
Stabilizator tensioni	4	10	8
Freskim mjedisi me kondicioner	10	2	0
Sherbime te tjera: kombinat kuzhine,ekspres kafeje, mikrovale tharese flokesh etj.	10	5	3
Totali	277	240	170
Efekti i humbjeve jo teknike	23	34	23
Totali ne kushte normale	254	206	147

Efekti i humbjeve jo teknike mbi sasine e konsumit mujor te energjise elektrike per nje familje eshte percaktuar duke i konsideruar ato per vitin 2001 ne masen 21%.

Duke parashikuar efektet e zhvillimit te pergjithshem dhe te faktoreve qe e shoqerojne kete zhvillim nepermjet analizes statistikore, Decon ka bere percaktimin e nevojës maksimale per energji elektrike te nje familje ne vitin 2015, e cila ne forme te permbledhur paraqitet ne tabelen -5-

Tabela -5- Kerkesa maksimale per energji elektrike, pa ngrohje, per nje familje ne vitin 2015

Lloji i Sherbimit	Konsumi ne zonat qe analizohen ne kWh/muaj		
	Tirana	Zonat e tjera urbane	Zonat rurale
Ndricim elektrik	50	50	50
Ftohje me frigorifer	45	45	45
Informacion me TV&Video	35	35	35
Informacion me marres satelit	3	7	7
Larje teshash me makine larese	30	30	27
Konsum ne mjediset e perbasheta	15	15	5
Informacion me sistem audio	20	20	20
Hekurosje teshash	10	10	10
Freskim me ventilator	15	15	15
Pastrim me fshese elektrike	8	8	8
Stabilizator tensioni	4	10	8
Freskim mjedisi me kondicioner	40	30	15

Larje enesh me makine	5	3	-
Perdorim Kompjuteri	9	8	5
Tharje teshash me thares elektrik	5	3	-
Te tjera: kositese bari, bluarse etj.	15	15	30
Sherbime te tjera: kombinat kuzhine,ekspres kafeje, mikrovale tharese flokesh etj.	15	15	12
Totali	317	301	277

1.7. Konkluzione nga "Vezhgimi i AKE-se" dhe Studimi i Decon-it

Nepermjet studimit te Decon-it eshte bere e mundur te percaktohet pesha specifike qe ze konsumi i energjise elektrike per nje sherbim te caktuar ndaj konsumit te pergjithshem familjar. Ne tabelen -6.- ky vleresim eshte bere per vitin 2001 dhe per vitin 2015.

Nga vezhgimi i AKE-se eshte bere percaktimi i sasise minimale te energjise elektrike per plotesimin e nevojave jetesore me energji elektrike te nje familjeje ne nevoje, e cila eshte vleresuar me 220 kWh/muaj si dhe e sasise minimale mbas se ciles fillon perdorimi per ngrohje, e cila eshte vleresuar 300 kWh/muaj.

Nepermjet vezhgimit te AKE-se percaktohet sasia minimale e energjise elektrike per te cilen nga ana e Qeverise duhet te zbatohen politikat e mbrojtjes sociale ndersa per kompanine e furnizimit me energji elektrike (KESH-in) percaktohet edhe cmimi i shitjes se energjise elektrike per bllokun e pare me 4.7 lek/kWh dhe per sasine mbi kete bllok me 10 lek/kWh.

Tabela -6- Pesha specifike e energjise elektrike per cdo sherbim ne familje

Lloji i Sherbimit	Pesha specifike ne %, e energjise per cdo lloj sherbimi ndaj energjise elektrike totale			
	Per Vitin 2001		Per Vitin 2015	
	kWh	%	kWh	%
Ndricim elektrik	59	21.30	50	15.77
Ftohje me frigorifer	62	22.38	45	14.19
Informacion me TV&Video	22	7.94	35	11.04
Informacion me marres satelit	3	1.08	3	0.94

Larje teshash me makine larese	45	16.24	30	9.46
Konsum ne mjediset e perbasheta	15	5.41	15	4.73
Informacion me sistem audio	20	7.22	20	6.31
Hekurosje teshash	10	3.61	10	3.15
Freskim me ventilator	10	3.61	15	4.73
Pastrim me fshese elektrike	7	2.53	8	2.52
Stabilizator tensioni	4	1.44	4	1.26
Freskim mjedisi me kondicioner	10	3.61	40	12.61
Larje enesh me makine	---	---	5	1.57
Perdorim Kompjuteri	---	---	9	2.84
Tharje teshash me thares elektrik	---	---	5	1.57
Te tjera: kositese bari, bluarje etj.	---	---	15	4.73
Sherbime te tjera: kombinat kuzhine, ekspres kafeje, mikrovale tharje flokesh etj.	10	3.61	15	4.73
Totali	277	100	317	100

Nga ana e Decon-it nuk merret persiper te percaktohet sasia e energjise elektrike per bllokun e pare dhe aqe me pak cmimet e energjise elektrike. Studimi i Decon-it vlereson se sa eshte sasia e energjise elektrike pa ngrohje te baneses dhe pa uje te ngrohet sanitar, qe konsumohet ne vitin 2001 nga nje familje ne tre zona karakteristike te vendit si dhe parashikimi per vitin 2015. Decon-i nuk percakton energjine per nevoja jetesore por percakton harxhimin specifik per cdo sherbim qe kryhet me energji elektrike ne familje duke perjashtuar ngrohjen. Simbas Decon-it ngrohja e baneses dhe ngrohja e ujit per qellime sanitare nuk parashikohen te kryhen me energji elektrike, por me burime energjetike alternative.

Sikurse shihet ka dy kendveshtrime te ndryshme te trajtimit te konsumit te energjise elektrike ne familje nga AKE-ja dhe Decon-i.

Duke gene se analiza e struktures sociale te popullise, e politikave sociale qe zbatohen nga ana e qeverise per mbrojtjen e shtresave ne nevoje trajtohen nga institucione te vecanta te shtetit sikunder edhe vleresimi i cmimeve dhe tarifave te energjise elektrike percaktohet nga nje institucion i pavarur, mendojme se bashkepunimi ndermjet ketyre institucioneve duke shfrytezuar te dhenat e vezhgimeve apo studimeve mbi konsumin familjar te energjise elektrike do te ishte menyra me e arsyeshme per trajtimin e ketij problemi me ndjeshmeri te larte sociale.

Zhvillimet qe nga viti 2001 e deri sot lidhur me faktoret qe nderthuren e bashkeveprojne ne konsumin familjar te energjise elektrike jane shkaku kryesor i hartimit te ketij studimi nga ana e ERE-s

KAPITULLI III.

PARIMET METODOLOGJIKE PER HARTIMIN E STUDIMIT NGA ERE

ERE e konsideron studimin e ndermare prej saje si produkt te nje pune te perbashket me institucionet qe trajtojne politikat sociale dhe te mbrojtjes se shtresave ne nevoje ne vendin tone si dhe te mbeshtetur edhe ne te dhenat e studimeve dhe vezhgimeve qe jane kryer deri me sot lidhur me konsumin familjar te energjise elektrike.

Vezhgimi i AKE-se kishte per qellim te percaktonte sasine minimale te energjise elektrike per plotesimin e nevojave jetike te shtresave ne nevoje te popullsisë, bazuar ne anketimin e nje numri te konsiderueshem familjesh ne terren dhe ne baze te ketij rezultati percaktohej shkalla e subvencionit shteteror per mbrojtjen e ketyre shtresave.

Aktualisht institucionet e mbrojtjes sociale dhe politikat perkatese per mbrojtjen e shtresave ne nevoje jane konsoliduar dhe egzistojne te dhena te mjaftueshme per te bere analiza me te detajuara per keto shtresa te popullsisë dhe nga ana tjetere INSTAT, nepermjet "Anketes se Matjes se Nivelit te Jeteses –LSMS-2008", qe perfaqeson nje projekt me shtrirje te gjere ne te gjithe vendin, sigurojne nje baze te gjere te dhenash lidhur me gjendjen ekonomike te shtresave ne nevoje dhe strategjite per mbrojtjen dhe perkrahjen e tyre.

Nisur nga ky realitet ERE vendosi qe studimin per konsumin e energjise elektrike ne familje ta trajtoje ne nje kendveshtrim te ri dhe pikerisht nga mundesite financiare te shtresave ne nevoje per te paguar faturen e energjise elektrike. Duke u analizuar keto mundesi ne koordinim me strukturen e konsumit faktik te energjise elektrike, sipas niveleve te konsumit, krijohen kushte per te marre ne konsiderate nje numur te madh opsionesh, per percaktimin e cmimeve dhe tarifave te energjise elektrike, madhesise se bllokut, shkalles se subvencionimit shteteror etj.

Nepermjet analizes se struktures se konsumit te energjise elektrike ne nivele te ndryshme konsumi behet e mundur nje analize me e sakte e nivelit te te ardhurave te kompanise furnizuese me energji elektrike dhe per pasoje edhe e vleresimit te cmimeve dhe tarifave te energjise elektrike.

ERE gjykon se analiza ne menyre komplekse e te gjithe faktoreve ne bashkepunim me institucionet qeveritare pergjegjese, ben te mundur qe madhesija e bllokut te mos jete determinuese ne strukturen tarifore te energjise elektrike per konsumatorët familjar, cka do te thote se cmimet dhe tarifat e reja te energjise elektrike duhet te percaktohen duke optimizuar ndikimin e te gjithe ketyre faktoreve.

Nga pikpamja rregullatore, nepermjet mekanizmit te cmimit te energjise elektrike, synohet te dekurajohet perdorimi i energjise elektrike per ngrohje te baneses dhe per gatim, mbasi per keto sherbime egzistojne alternativa energjetike te tjera te cilat edhe nga pikpamja ekonomike dhe ajo e konfortit, jane plotesisht te justifikueshme dhe ofrohen ne tregun e brendshem energjetik.

Por edhe kombinimi i politikave subvencionuese te Qeverise, per kategorine e konsumatoreve me te ardhura te pakta, me sistemin tarifor te diferencuar sipas shkalles se konsumit te energjise elektrike, eshte nje praktike qe perdoret ne shume vende te botes.

Duke u nisur nga keto kosiderata studimi eshte kryer nepermjet nje bashkepunimi te ngushte te ERE-s me Departamentin e Shitjes se Eenergjise Elektrike ne OSSH, (ne vijim DSh), me Ministrine e Punes, Perkrahes Sociale dhe Shanseve te Barabarta (ne vijim MP) si dhe me Institutin e Statistikave, (ne vijim INSTAT).

ERE vleresimin e nevojës per energji elektrike per konsum familjar e bazon ne strukturen e familjes se sotme mesatare shqiptare. Sipas Institutit te Statistikave kjo strukture perbehet nga 4 persona, nje cift bashkeshortor dhe 2 femije.

Si pjese e studimit te ERE-s eshte edhe matja e konsumit specifik te energjise elektrike per nje numer te konsiderueshem sherbimesh elektroshtepijake. Nepermjet ketyre te dhenave dhe struktures se konsumit te energjise elektrike ne familje, sipas studimit te Decon-it, duke perdorur metoden e interpolimit per vleresimin e vitit 2008, ne intervalin e te dhenave 2001-2015, eshte bere e mundur te percaktohet sasija e sherbimeve elektroshtepijake qe mund te kryhen brenda limiteve te bllokut te pare si dhe brenda limiteve te konsumit te energjise elektrike pa ngrohje dhe gatim.

Energjia elektrike per gatim ne arsyetimin e studimeve te Bankes Boterore dhe AKE-se konsiderohet si energji elektrike per plotesim nevojash jetesore, per pasoje ajo eshte pjese e konsumit brenda limiteve te bllokut te pare, parim te cilin e respektojme edhe ne. Por persa i perket perdorimit te energjise elektrike per ngrohjen e ujit per qellime sanitare ne familje per te gjithë konsumatorët jashte limitit te bllokut te pare, ERE ka mendim te ndryshem.

Aktualisht ne vendin tone 100% e familjeve ne qytet dhe rreth 60% e familjeve ne zonat rurale perdorin energjine elektrike per ngrohjen e ujit sanitar nepermjet ngrohjesve elektrik (bojlereve elektrik). Numri i tyre eshte mbi 700 mije. Ne kushtet kur alternativa e perdorimit te paneleve diellore termike eshte e paperfillëshme (ajo mbulon vetem rreth 1-1.5% te nevojave per uje te ngrohet sanitar ne familje) ndersa alternativa e ngrohjes se centralizuar te baneses eshte gjithashtu shume e kufizuar, alternativat e tjera (ngrohja e ujit me kazan me gaz, vajguri apo me dru) per opinionin e sotem publik dhe standartin e sotem te jeteses konsiderohen nje atavizem dhe nje kthim mbrapa ne procesin e zhvillimit. Ne keto kushte, per konsumin e energjise elektrike jashte bllokut te pare, ERE e konsideron ngrohjen e ujit sanitar me energji elektrike si alternative te pranueshme ndersa gatimin, per kete kategori konsumatorësh, e vlereson te mundshem me burim tjetër energjetik. Aktualisht perdorimi i gazit te lenget per gatim ne familje po merr perhapje gjithnje e me te

madhe mbasi ai nga pikpamja e konfortit dhe efciences eshte i krahasueshem me energjine elektrike dhe per pasoje i pranueshem nga konsumatori.

Duke qen se sipas te dhenave sasite e energjise elektrike per gatim dhe per uje te ngrohet sanitar vleresohen si ekuivalente, ne strukturen e konsumit te energjise elektrike per nevoja shtepiake nuk do te parashikohen ndryshime.

1.8. Politikat energjetike per mbrojtjen e konsumatoreve familjar ne nevoje:

Nje nga elementet e rendesishem te studimit per percaktimin e kerkesave minimale per energji elektrike te familjeve ne nevoje eshte pa dyshim analiza dhe marrja ne konsiderate e politikave dhe strategjive qeveritare per mbeshtetjen e kategorive te familjeve ne nevoje, ne menyre qe ato te jene ne gjendje te perballojne financiarisht pagesen e fatures se energjise elektrike.

Metodikisht egzistojne dy mundesi per hartimin e politikës se cmimeve dhe tarifave te energjise elektrike per konsumatorët ne pergjithesi dhe per ata ne nevoje ne vecanti:

- a- Vendosja e nje cmimi te njejte per te gjithe konsumatorët familjare, dhe mbeshtetja e familjeve ne nevoje nga ana e Qeverise, nepermjet kompensimit financiar, ne menyre qe ata te jene te mbrojtur nga rritja e cmimit te energjise elektrike.
- b- Perdorimi i mekanizmit te cmimeve dhe tarifave te energjise elektrike si nje instrument per te dekurajuar perdorimin e energjise elektrike per ngrohje te baneses dhe per gatim si dhe per mbrojtjen e familjeve ne nevoje.

Metoda e pare eshte me e thjeshte ne zbatim, dhe me e preferuar nga ana e kompanive te furnizimit me energji elektrike.

Metoda e dyte eshte me e nderlikuar ne zbatim, por ajo mund te perdoret per mbrojtjen sociale te shtresave ne nevoje, por edhe per te rritur eficiencen e perdorimit te energjise elektrike nepermjet dekurajimit te te perdorimit te saj per ngrohjen e baneses.

Te dyja metodat kane gjetur perdorim qofte ne planin nderkombetar po ashtu dhe ne ate kombetar. Por aktualisht, ne te gjitha vendet e BE-se ka gjetur zbatim metoda e dyte e tarifimit te energjise elektrike.

Per qellimet e ketij studimi do te shqyrtojme zbatimin e metodes se dyte.

1.9. Politikat e derisotme qeveritare per mbrojtjen e familjeve ne nevoje:

Per hartimin e kesaj analize i jemi referuar te dhenave zyrtare te marra nga Ministria e Punes Perkrahes Sociale dhe Shanseve te Barabarta.

Mbrojtja e familjeve te varfëra nga rritja e çmimit të energjisë elektrike në vitin 2003 filloi me zbatimin e skemës së kompensimit nga efekti i rritjes se çmimit të energjisë elektrike. Zbatimi në praktike i skemës nuk e dha impaktin e synuar. Vetëm 37.000 ose 20% e familjeve u përfshinë në skemë dhe e përfituan rimbursimin për rritjen e çmimit të energjisë, nga 191.500 familjet gjithsej që ishte parashikuar të përfitonin nga ky program. Programi nuk i nxiti familjarët e varfër për të paguar faturat e energjisë. Norma e mospagesës nga familjet e varfëra ishte dy herë më e lartë se sa norma e mospagesës nga familjet e tjera. Mekanizmi administrativ i skemës u ballafaqua edhe me probleme teknike. Keshtu lista emerore e përfituesve e hartuar nga Ministria e Punes, me listen emerore qe dispononte KESH-i sipas kontratave te furnizimit me energji elektrike per cdo konsumatorpërputheshin vetëm në masën 25%. Koha e pergatitjes se dokumentacionit dhe shpërndarja e informacionit midis institucioneve përgjegjëse për implementimin e kësaj skeme (njësitë vendore, ISSH, SHSSH dhe KESH) bëhej me vonesë dhe krijonte vështirësi për disbursimin e fondeve.

Politika e subvencionit u përmirësua më tej në qershor të vitit 2006, me synim rritjen e masës së tij dhe zgjerimin e grupeve përfituese për mbrojtjen e tyre nga rritja e mëtejshme e çmimit të energjisë elektrike. Nga ana tjetër u be edhe përmirësimi i administrimit të skemes se subvencionit për energjinë elektrike.

1.10. Kategorite perfituese

Subvencioni per kompensimin financiar te familjeve ne nevoje nga rritja e cmimit te energjise elektrike mbulon keto grupe përfituesish:

- a) Familjet qe trajtohen me ndihmë ekonomike, konsiderohen si te tilla familjet pa asnje te ardhur;
- b) Familjet që kanë në përbërje anëtarë me aftësi të kufizuara (te verber, para-tetraplegjike, etj.), të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të KMCAP-it (Komisioni Mjeksor i Caktimit te Aftesise per Pune)

Subvencioni per dy kategorite e siperpermendura është bërë pjesë e listës së pagesës së ndihmës ekonomike që merret në njësitë vendore;

- c) Kryefamiljarë që përfitojnë pension invaliditeti, shtetëror dhe nuk kanë anëtarë të familjes të punësuar në sektorin publik ose të vetepunësuar në sektorin privat.

Subvencioni per kete kategori pasqyrohet në një kolonë të veçantë në listpagesën e punonjesve me aftësi të kufizuar qe ndodhet pranë njësisë vendore perkatese.

- d) Kryefamiljarë që përfitojnë pension pleqërie shtetëror dhe jetojnë të vetëm ose kanë fëmijë në ngarkim, të cilët nuk kanë të ardhura.

Subvencioni per kete kategori është shprehur ne nje kolone te vecante të listpagesës se marrjes së pensionit nga ana e Institutit te Sigurimeve Shoqerore.

- e) Familjet e punonjësve buxhetorë, me pagë mujore bruto nën 35.000 lekë në muaj.

Subvencioni për këto kategori është përfshirë si zë i veçantë në listpagesën e institucionit përkatës shtetëror.

Ne tabelën -4.1.- jepet numri i familjeve përfituese për secilin grup social i cili kompensohet për rritjen e cmimit të energjisë elektrike. Në total, ky numur abonentesh për vitin 2008 arrinte në 272 mijë.

Tabela -7- **Kategoritë përfituese të shtresave në nevojë të subvencionit nga shteti**

Nr.	Kategoritë Përfituese	Numeri i personave përfitues për vitin 2008
1.	Pensioniste	50.000
2.	Ndihme Ekonomike	93.000
3.	Invalide pune	35.000
4.	Te verber	15.000
5.	Para-Tetraplegjike	6.000
6.	Te paafte të tjere	53.000
7.	Buxhetore	11.000
8.	Pagese papunesie	9.000
	Gjithsej	272.000

1.11. Percaktimi i vlerës së kompensimit financiar:

Koncepti i mbrojtjes së familjeve në nevojë nga rritja e cmimit të energjisë elektrike për konsumatorët familjare në vitin 2006, nga 4.5 Lek /kWh në 7 lek/kWh, konsistoi në kompensimin e rritjes së cmimit (7- 4.5 = 2.5 Lek/kWh) nga ana e Buxhetit të Shtetit, për sasinë e energjisë elektrike prej 200kWh/Muaj. Në këtë mënyrë vlera mujore e kompensimit financiar nga ana e shtetit, për kompensimin e rritjes së cmimit të energjisë elektrike rezultoi me 500 Lek/Muaj për çdo familje në nevojë. Simbas kësaj filozofie, familjeve në nevojë, për sasinë e energjisë elektrike prej 200kWh/Muaj, e cila konsiderohej si sasi minimale e nevojshme për këto kategori konsumatorësh me të ardhura të pakta, nuk ju bë asnjë rritje cmimi, në një kohë kur për të gjitha kategoritë e tjera të konsumatorëve cmimet u rriten.

Gjatë vitit 2008, për zbatimin e kësaj skeme kompensimi, nga ana e buxhetit të shtetit u financua një shumë prej 1 miliardë lekë.

1.12. Skema e subvencionit :

Mbas vitit 2005 skema e subvencionimit te familjeve ne nevoje u përmirësua duke saktësuar kriteret dhe dokumentacionin e nevojshem për identifikimin e përfituesve të subvencionit të energjisë elektrike:

- përfituesit, përcaktohen nga institucionet ku ata marrin pagën, pensionin apo pagesat nga programet e ndryshme sociale;
- konsumi i energjisë elektrike, faturohet nga furnizuesi i energjise elektrike, për të gjithë sasinë e energjisë së konsumuar nga familjet përfituese;
- klientët, familjet përfituese të subvencionit e paguajnë të gjithë detyrimin sipas faturës dhe mbas këtij momenti paraqiten për të tërhequr subvencionin;
- familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike apo me pagesë për aftësinë e kufizuar deklarojnë detyrimet e prapambetura për energjinë;

1.13. Kushtëzimet per perfitimin e subvencionit me pagesën e konsumit të energjisë elektrike:

Me qellim qe subvencioni i akorduar per kompensimin e cmimit te energjise elektrike te sherbeje per qellimin per te cilin jepet, nga ana e Ministrise se Punes eshte bere kushtëzimi i shpërndarjes së Ndihtmes Ekonomike, me pagesën e fatures se energjisë elektrike nga ana e familjeve perfituese si me poshte:

- Kompensimi do të kushtëzohet me pagesën e faturës së energjisë elektrike per 200 Kwh e parë të konsumuar nga familjet e përfshira në skemë.
- Pagesa per kompesimin e energjise elektrike, kryhet në të njëjtën kohë me pagesën e ndihmës ekonomike; pagesën e PAK, pensionin e pleqerise apo invaliditetit, pagën për punonjësit buxhetorë. Kompesimi përfshihet si kolonë e veçantë në listpagesat e përfituesve të mësipërm.
- Përfitimi i Ndihtmes Ekonomike, i pageses se aftesise se kufizuar, i perfitimit si punonjes buxhetor me page nen 35 mije Leke/Muaj, i perfitimit nga pensionistet e vetmuar dhe invalidet e punes, akordohet vetem ne rast se perfituesit paraqesin likuidimin e fatures se energjise elektrike, ne te kunderten humbasin te drejten e perfitimit te kompensimit dhe te ndihmes ekonomike, apo perfitimeve te tjera te cituara me larte.

1.14. Treguesit statistikore te buxhetit familjar per energji elektrike:

Ne analizen e konsumit minimal te nevojshem te energjise elektrike per familjet me te ardhura te pakta te cilat perfitojne ndihme ekonomike ose subvencion nga shteti si dhe kompensim nga rritja e cmimit te energjise elektrike, i jemi referuar te dhenave

te marra nga Instituti Shqiptar i Statistikave nepermjet projektit: “Anketa e matjes se nivelit te jeteses – LSMS-2008”.

Tabela -8- **Buxheti Mesatar Mujor i Familjes**

Numri Gjithesej i Familjeve	Me te ardhura te pakta Lek/Muaj	Me te Ardhura Jo te pakta Lek/Muaj	Mesatarisht Lek/Muaj
791,830	25,357	45,000	43,203

(Burimi “INSTAT”)

Ne tabelen -4.2.-, ne menyre te permbledhur, jane paraqitur treguesit kryesor sintetik te buxhetit familjare per dy kategori familjesh, kurse ne Tabelen -4.3.- tregohet se cfare pjese te buxhetit mujor familjare perfaqson shpenzimi mujor per konsum te energjise elektrike.

Tabela -9- **Buxheti Mesatar Mujor i Familjes per Energji Elektrike**

Numri Gjithesej i Familjeve	Me te ardhura te pakta		Me te Ardhura Jo te pakta		Mesatarisht	
	Lek/Muaj	%	Lek/Muaj	%	Lek/Muaj	%
791,830	1,775	7	2,385	5.4	2,333	5.3

(Burimi “INSTAT”)

Per te llogaritur se sa eshte madhesia e energjise elektrike qe i korespondon pageses mujore prej 1775 Leke, formojme ekuacionin e thjeshte:

$$(a * 7) 1.2 = 1775$$

ku “a” - sasija e kerkuar mujore e energjise elektrike ne kWh.

7 - tarifa e energjise elektrike per bllokun e pare 7 Lek/kWh.

1.2 - Vlera e TVSH-se (20% e vleres se energjise se faturuar)

Nga zgjidhja e ketij ekuacioni sasia e energjise elektrike mujore qe shpenzohet nga familjet me te ardhura te pakta rezulton 211 kWh/Muaj, kurse shpenzimi per pagesen e kesaj sasije energjie perben 7% te te ardhurave mujore te ketyre familjeve.

Ne menyre analoge veprohet edhe per llogaritjen e sasise mujore te energjise elektrike qe konsumohet nga familjet me te ardhura mesatare dhe me te ardhura jo te pakta,ose mbi mesataren.

Ne tabelen -4.4.- eshte paraqitur konvertimi i buxhetit familjar te ketyre tri kategorish familjesh ne konsum mujor te energjise elektrike duke ju referuar cmimeve te energjise elektrike per vitin 2008.

Tabela -10- **Konsumi Mesatar Mujor i Energjise Elektrike ne Familje**

Numri Gjithesej i Familjeve	Konsumi Mesatar Mujor i Energjise Elektrike ne Familje		
	Me te ardhura te pakta kWh/Muaj	Me te Ardhura Jo te pakta kWh/Muaj	Mesatarisht kWh/Muaj
791,830	211	284	277

Nga te dhenat e OSSH-es rezulton se kategorija e familjeve me te ardhura te pakta qe perfiton nga ndihma ekonomike, perfaqeson nje kategori konsumatoresh korrekt, te cilet e paguajne rregullisht faturen e energjise elektrike te konsumuar.

1.15. Disa perfundime nga marredheniet: “konsumator – te ardhura dhe konsum energjie elektrike”

Ne analizen e deritanishme shqyrtimi i nevojës minimale te domosdoshme per energji elektrike, te konsumatoreve me te ardhura te pakta, ose madhesija e “Bllokut te Pare” ne kWh eshte shqyrtuar nga pikpamja sociale dhe ekonomiko-financiare. Ne kete analize jane shqyrtuar marredheniet ndermjet konsumatoreve te kesaj kategorie (familjeve me te ardhura te pakta), mbeshtetjes se tyre financiare nga Qeveria, menyres se mbeshtetjes, te ardhurave mesatare mujore, shpenzimeve per energji elektrike dhe sasise se energjise elektrike qe konsumohet nga keto familje sipas te dhenave statistikore. Po ashtu nje analize e hollesishme eshte bere edhe sipas te dhenave te faturimit te O.S.SH-se nepermjet se ciles shprehet marredhenija ndermjet numrit te konsumatoreve familjare dhe energjise elektrike te konsumuar prej tyre per cdo interval konsumi nga 0 deri ne 600 kWh/Muaj.

Analiza e hollesishme e ketyre marredhenieve krijon mundesine qe me objektivitete te gjykohet per sasine minimale te nevojshme te energjise elektrike (ose per sasine e energjise elektrike te “Bllokut te Pare”) nga pikpamja e aftesise paguese te

kesaj kategorie konsumatoresh ne kontekstin e te ardhurave te pergjitheshme te tyre duke marre ne konsiderate edhe perkrahjen financiare nga shteti, sipas menyre aktuale te trajtimit te saje.

Nga perpunimi i te dhenave te tabelave -2.2.- dhe -4.4.- eshte hartuar tabela permbledhese -4.5.-

Duke krahasuar te dhenat e perftuara nga regjistri i faturimeve te OSSH-se vihet re se ne kategorine e konsumatoreve me konsum mujor deri ne 250 kWh/Muaj, bejne pjese 391,658 konsumatore familjare, ose 55.19% e numrit te pergjithshem te konsumatoreve familjare prej 852,361 konsumatore.

Tabela -11- **Tabela permbledhese**

Sipas Regjistrimit te Faturimeve ne O.S.SH viti 2008.						
Konsumi Mujor	Numuri i Abonenteve Familjare		Konsumi Mesatar i Faturuar		Konsumi Mesatar Real	
	kWh/Muaj	Abonente	%	GWh/Muaj	kWh/Muaj	GWh/Muaj
Deri 250	391,658	46.0	55.19	141	65.1	166
Sipas Ministrise se Punes dhe INSTAT per vitin 2008						
Deri 250	272,000	34.4	57.39	211	-	-

Per kete kategori konsumatoresh, konsumi mesatar mujor, i faturuar, i energjise elektrike, eshte 141 kWh/Muaj, ndersa konsumi mesatar mujor, real, i energjise elektrike, eshte 186 kWh/Muaj. Duhet te shtojme se ne keto vleresime nuk eshte mare ne konsiderate numri i konsumatoreve familjar me konsum mujor 0 kWh.

Per te njejtin interval konsumi, d.m.th. deri ne 250 kWh/Muaj, sipas te dhenave te Ministrise se Punes dhe INSTAT-it, numri prej 272,000 familjesh, me te ardhura te pakta, sipas bilancit te te ardhurave mujore dhe shpenzimeve per energji elektrike, paguan cdo muaj nje shume ne te holla per shlyerjen e nje konsumi energjie elektrike mesatarisht prej 211 kWh. Llogaritja eshte kryer duke marre ne konsiderate edhe TVSH-ne.

Nga keto te dhena rezulton se kategoria sociale e familjeve me te ardhura te pakta ben pjese ne grupin e konsumatoreve te OSSH-se me konsum mesatar mujor deri ne 250 kWh/Muaj.

Ne se do ti referoheshim bllokut aktual te konsumit prej 300 kWh/Muaj, per te cilin cmimi i energjise elektrike ka mbetur i pandryshuar me 7 Lek/kWh, do te perftonim, sipas principeve te trajtuara deri tani, te kesaj analize, te dhenat e paraqitura ne tabelen -4.6.-

Tabela -12- **Konsumi sipas Regjistrir te Faturimeve ne O.S.SH viti 2008**

Konsumi Mujor	Numuri i Konsumatoreve Familjare		Konsumi Mesatar i Faturuar		Konsumi Mesatar Real	
	kWh/Muaj	Konsumatore	%	GWh/Muaj	kWh/Muaj Per konsumator	GWh/Muaj
Deri 300	473,046	55.5	79.2	166	93.5	198

(Burimi: DSh)

Nje tregues tjetër domethenes është treguesi i konsumit mesatar të energjisë elektrike të faturuar për konsumatorët familjare, në shkallë vendi, i cili për vitin 2008 rezultoi me 213.9 kWh/Muaj, kurse për konsumin real, i cili më në konsideratë edhe humbjet jo teknike është 252.4 kWh/Muaj. Nëse do të përjashtonim numrin e konsumatoreve me konsum mujor “zero”, të cilët vlerësohen 181,291, atëherë konsumi mesatar mujor i faturuar i energjisë elektrike për konsumatorët familjare do të rezultonte 272 kWh/Muaj, ndërsa konsumi real 321 kWh/Muaj.

Fatura e energjisë elektrike, duke marrë parasysh edhe TVSH-ne, për konsumin mujor të bllokut të parë ekzistues prej 300 kWh/Muaj rezultoi 2520 Leke. Nga të dhënat e tabelës -4.3.- buxheti mesatar mujor për pagesën e energjisë elektrike, i familjeve me të ardhura të pakta, të cilat përfitojnë ndihmë nga shteti, është 1,775 Lek/Muaj.

Nga këto të dhëna arrijmë në përfundimin se blloku ekzistues prej 300 kWh/Muaj i cili është përcaktuar nga ERE sipas sasisë minimale për të cilën fillon përdorimi i energjisë elektrike për ngrohje dhe që ka për synim dekurajimin e përdorimit të energjisë elektrike për ngrohje është më i madh nga ai që duhet të ishte sipas analizës për t’ju shërbyer vetëm familjeve në nevojë.

Nga pikpamja e aftësisë paguese të familjeve me të ardhura të pakta, blloku i parë do të ishte i arsyeshëm në masën 210 kWh/Muaj.

Nga interpolimi i të dhënave të tabelës -3.3- për vitin 2008 dhe për sasi të energjisë elektrike për bllokun e parë prej 210 kWh/muaj, për konsumin prej 300 kWh/muaj si dhe duke marrë parasysh rekomandimet mbi rritjen e eficientës nga avancimi i teknologjisë ndërtojmë tabelën -4.7.- në të cilën paraqitet struktura e

konsumit te energjise elektrike per keto dy sasi konsumi dhe sasia perkatese e konsumit te energjise elektrike per cdo sherbim te kryer.

Tabela -13- Pesha specifike ne %, e energjise per cdo lloj sherbimi ndaj energjise elektrike totale

Lloji i Sherbimit	Per bllokun e pare dhe per 300 kWh			
	Per 210 kWh/muaj		Per 300kWh/muaj	
	%	kWh	%	kWh
Ndricim elektrik	24.2	50	11.66	35
Ftohje me frigorifer	9.57	22	10.69	32
Informacion me TV&Video	8.49	18	9.63	29
Informacion me marres satelit	--	--	2.01	6
Ngrohje uji sanitar	--	--	19.33	58
Larje teshash me makine larese	12.85	27	10.05	31
Gatim me energji elektrike	27.45	58	--	--
Konsum ne mjediset e perbasheta	8.07	17	7.07	21
Informacion me sistem audio	--	--	3.76	11
Hekurosje teshash	3.20	7	3.38	10
Freskim me ventilator	6.17	13	--	--
Pastrim me fshese elektrike	--	--	2.52	8
Freskim mjedisi me kondicioner	--	--	12.11	36
Larje enesh me makine	--	--	4.17	14
Perdorim Kompjuteri	--	--	2.84	9

KAPITULLI IV.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

4.1 Konkluzione te studimit

- Analiza e konsumit te energjise elektrike ne familje perfaqson nje nga problemet qe nuk mund te shteret nje here e pergjithmone me anen e ndonje studimi sado cilesor qe te jete ai. Perditesimi i analizave si nje proces i vazhdueshem per reflektimin e zhvillimeve strukturore, sasiore, te politikave mbrojtese per kategori te caktuara konsumatoresh familjare, cmimeve dhe tarifave te energjise elektrike etj. duhet te mbetet nje praktike e vazhdueshme nga institucionet perkatese.
- ERE vleresimin e nevojës për energji elektrike për konsum familjar e bazon në strukturën e familjes së sotme mesatare shqiptare. Sipas Institutit të Statistikave kjo strukturë përbehet nga 4 persona, një çift bashkeshortor dhe 2 fëmijë.
- Nga pikpamja teknike, studimi është realizuar nëpërmjet vleresimit të konsumit specifik të energjisë elektrike, për çdo lloj shërbimi në vecanti. Nga studimi i AKE-së dhe Decon-it, konsumi deri 300 kWh/muaj, ka rezultuar si kufiri maksimal i konsumit të një familjeje e cila nuk përdor ngrohje të banesës dhe të ujit sanitar me energji elektrike. Duke respektuar peshën specifike që ze çdo shërbim familjar me energji elektrike, sipas studimit të Decon-it, i interpoluar për vitin 2008, si dhe i korrigjuar edhe me të dhënat e matjeve teknike dhe të zhvillimit teknologjik, është bërë vlerësimi i shërbimeve që mbulojnë me energji elektrike gjatë një muaji për një familje pa ngrohje për konsumin deri 300 kWh/muaj.
- Nga studimi i ERE-s, konsumi maksimal i energjisë elektrike të cilin janë në gjendje ta paguajnë familjet në nevojë nëpërmjet perkrahjes aktuale sociale nga ana e shtetit rezultoi 210 kWh/muaj. Edhe për këtë « Bllok Social » konsumi të energjisë elektrike, është bërë vlerësimi i shërbimeve që mbulojnë me energji elektrike, duke u bazuar në të njëjtat kritere që përmenden më lartë

- Ne kushtet e vendit tone, konsumi i energjise elektrike per nevoja shtepijake kundrejt energjise elektrike te faturuar eshte determinues, mbasi per vitin 2008 perbente 57% te energjise se faturuar. Ne keto kushte merr rendesi paresore konsumi racional dhe me eficience te larte i kesaj energjie. Per fat te keq niveli i humbjeve jo teknike eshte atribut kryesisht i konsumatoreve familjare, te cilet me aktin e pervesimit te energjise elektrike jane nga kontribuesit me te medhenj te rritjes se paperligjur te cmimeve dhe tarifave te energjise elektrike.
- Nepermjet studimeve analizuese te konsumit familjar te energjise elektrike krijohet per ERE-n nje baze e shendoshe njohjeje per te kerkuar dhe per te adoptuar struktura cmimesh dhe tarifash te cilat synojne te marrin ne konsiderate te gjithe faktoret ndikues per vendosjen sa me racionale dhe te drejte te cmimeve dhe tarifave te energjise elektrike.
- Eshte shume e rendesishme qe veprimtaria e ERE-s te mbetet nje veprimtari rregullatore ne tregun e energjise elektrike ndersa politikat mbrojtese per kategorite sociale ne nevoje te mbeten pergjegjesi e institucioneve shteterore te ngarkuara me ligj. ERE do te perpiqet te nxise zhvendosjen nga mekanizmat e ndersubvencionimit te konsumatoreve te energjise elektrike drejt mekanizmeve te subvencioneve direkt nga shteti, duke permbushur keshtu detyrimet e parashikuara ne ligj dhe ne Traktatin e Komunitetit te Energjise.
- Ne politiken e cmimeve dhe tarifave te energjise elektrike per konsumatoret familjare dhe jo familjare, koncepti i cmimeve sipas blloqeve te konsumit te energjise elektrike i nenshtrohet, si rregull, filozofise klasike te maredhenieve te tregut, per sasi me te medha konsumi, cmime me te uleta, ndersa krijimi i blloqeve te konsumit, per mbrojtjen e shtresave ne nevoje, gjen perdorim ne fazen tranzitore te konsolidimit te nje tregu konkurses, sikurse jane edhe kushtet e vendit tone.
- ERE e vlereson procesin e tarifimit te energjise elektrike me blloqe si nje proces mjaft kompleks dhe marrja e vendimit per cmimet dhe tarifate e vitit 2010 do t'i nenshtrohet nje analize shume te kujdesshme duke marre ne shqyrtim disa variante tarifimi. ERE do te reflektoje politikat qeveritare per mbrojtjen e shtresave ne nevoje duke eleminuar ne maksimum mundesite e ndersubvencionimit ndermjet kategorive te ndryshme te konsumatoreve.

- ERE e kryen këte analize duke e përjashtuar përdorimin e energjisë elektrike për ngrohje të banesës, mbasi plotësimi i nevojave të popullsisë për këte shërbim familjar, në kushtet e tregut aktual të energjisë në vendin tonë, ofrohet nga alternativa të tjera që realizojnë të njëjtin konfort dhe me çmime konkurruese.
- ERE e konsideron standardin e jetesës së shoqërisë së sotme shqiptare në atë nivel zhvillimi që i përket aspiratave të qytetërimit të sotëm bashkëkohor dhe që synon të bëhet pjesë e qytetërimit të Bashkimit Evropian për një periudhë relativisht të shkurtër. ERE e ka për detyrë, që reformat e çmimeve të energjisë elektrike, si një reformë me ndjeshmëri shumë të lartë sociale, ta trajtojë me shumë kujdes, duke ruajtur balancat e duhura si për mbulimin e kostove të furnizimit me energji elektrike, rritjes së performancës së korporatës dhe ruajtjes së të jetë e mundur me shumë të nivelit të arritur të cilësive së jetesës së qytetarëve.
- Viti 2009 përfaqëson realisht vitin gjatë të cilit konsumi i energjisë elektrike në familje por dhe në shkallë të përgjithshme (në total) është i barabartë me kërkesën për energji elektrike, mbasi gjatë këtij viti nuk ka pasur dhe parashikohet të mos ketë asnjë ndërprerje të planifikuar të energjisë elektrike. Analiza e konsumit familjar mbi bazën e kërkesës reale për energji elektrike rrit saktësinë e vlerësimeve për të gjithë strukturën e konsumit por edhe për bilancin e të ardhurave dhe shpenzimeve të kompanisë së furnizimit me energji elektrike.

4.2 Rekomandime të studimit

- ERE i rekomandon institucioneve shtetërore përgjegjëse që në bashkëpunim me sipërmarrjen private dhe me politika kreditimi dhe fiskale nxitëse, të inkurajojnë transferimin e teknologjive përkatëse për të bërë të mundur prodhimin në vend të paneleve diellore termike me kosto sa më të ulët për një shfrytëzim masiv të energjisë diellore për përftimin e ujit të ngrohet sanitar, sikurse një gjë e tillë bëhet me shumë sukses, në të gjitha vendet mesdhetare.
- Një nga elementet e rëndësishëm për rritjen e eficientës së energjisë elektrike në familje dhe për paksimin e kërkesës për energji elektrike është përdorimi i llampave elektrike për ndricim me eficientë të lartë si dhe e të gjitha pajisjeve elektroshtepiake me rendiment të lartë, e kombinuar kjo me një administrim me kursim të energjisë elektrike duke eliminuar konsumet e panevojshme ose duke evituar qëndrimin në regjimin « stand-by » të pajisjeve elektronike.

- ERE i rekomandon institucioneve pergjegjese per hartimin e mekanizmave te subvencionit te konsumatoreve ne nevoje te energjise elektrike dhe OSSH sh.a., te bashkepunojne per saktesimin dhe perditesimin e listave te ktyre konsumatoreve qe perfitojne subvencionin, me qellim berjen sa me efektive te zbatimit te mekanizmit te subvencionit aktualisht ne fuqi.
- Ne te ardhmen ERE synon qe mekanizmi i subvencionit nepermjet blloqeve te mund te perqendrohet vetem ne grupin e synuar te konsumatoreve ne nevoje te energjise elektrike, vetem pas saktesimit te listes se konsumatoreve qe e perfitojne kete subvencion, si nje hap perpara drejt mekanizmave te subvencionit direkt.

ANEKS -1-

TEKNIKA E MATJES SE KONSUMIT SPECIFIK TE ENERGIJISE ELEKTRIKE:

Matjet e konsumit te energjise elektrike jane kryer ne menyre individuale per cdo pajisje elektrike qe kryen nje nga sherbimet e paraqitura ne paragrafin -3-.

Matjet jane kryer me nje aparat mates digital multifunksional i shkalles se saktetise 1.0. Karakteristikat teknike te aparatit mates jane paraqitur ne Tabelen-14-

Tabela -14- **Karakteristikat teknike te aparatit mates multimeter**

Nr.	Emertimi	Karakteristikat Teknike
1	Multimeter Digital	Tip:”brennenstuhl” PM-230
2	Numri i Serise	1506215
3	Sistemi	Njefazor
4	Klasa e Saktetise	1.0
7	Matje e faktorit te fuqise “ $\cos\varphi$ ”	Kufijt e Matjes: 0 - 1
8	Rryma maksimale e punes	16 A.
9	Tensioni Nominal	230 V.
10	Frekuenca Nominale	50 Hz.

Nepermjet ketij aparati me shume opsione behet e mundur: matja e tensionit, rrymes, fuqise aktive, $\cos\varphi$, energjise aktive, tarimit te cmimit me dy tarifa, kohes se punes, dhe vleres se energjise aktive te harxhuar sipas tarifave te vendosura.




Figura 10. Skema elektrike princiiale e aparatit mates multifunksional

Skema elektrike princiiale e lidhjes se aparatit mates multifunksional ne rrjetin elektrik ushqyes (prize njefazore) 220 V, 50 Hz dhe me konsumatorin te cilit do ti matet energjia elektrike e shpenzuar si dhe parametrat e tjere elektrik eshte paraqitur ne Figuren -11-.



Foto 11. Pamje e aparatit mates multifunksional Tip “brennenstuhl” PM-230

1.16. -Operacionet e matjes se energjise elektrike specifike:

a) Matja e konsumit specifik per ngrohje uji sanitar me bojler elektrik:

Matja eshte kryer ne nje bojler familjar qe perdoret rendom nga familjet ne vendin tone. Karakteristikat teknike dhe rezultatet e matjeve jane paraqitur ne Tabelen - 15 -

Tabela - 15- Karakteristikat teknike dhe rezultatet e matjeve te boliereve per 60°C°

Nr.	Emertimi	Karakteristikat Teknike
1	Bojler:	Tip: "Ariston", Kapacitet: 80 Litra, Montim: Vertikal.
6	Fuqia efektive	$P_p=1860$ W, 50 Hz. njefazore.
7	Tensioni i matur.	$U_p= 228$ V.
8	Rryma e matur	$I_p= 8.2$ A.
9	Temperatyra e mjedisit:	18 C°
10	Temperatura e ujit te nxehte:	60°C°
11	Energjia elektrike e shpenzuar gjate 24 oreve :	3.57 kWh.

Matjet u kryen gjithashtu edhe ne nje bojler tjetër por me termostat te graduar ne temperatyren maksimale. Rezultatet e matjeve jane paraqitur ne Tabelen -16-, kurse ne Foto -12- eshte paraqitur nje pamje reale e realizimit te matjes.



Foto 12. Matja e Konsumit specific ne nje bojler 80 litra, vertikal

Tabela -16- Karakteristikat teknike dhe rezultatet e matjeve te boliereve per 90°C°

Nr.	Emertimi	Karakteristikat Teknike
1	Bojler:	Tip: "Ariston", Kapacitet: 80 Litra, Montim:

		Vertikal.
6	Fuqia efektive	$P_p = 1145 \text{ W}$, 50 Hz. njefazore.
7	Tensioni i matur.	$U_p = 228 \text{ V}$.
8	Rryma e matur	$I_p = 4.96 \text{ A}$.
9	Temperatyra e mjedisit:	18 C°
10	Temperatyra e ujit te nxehte:	90°C°
11	Energjia elektrike e shpenzuar gjate 24 oreve :	5.09 kWh.

Ne Tabelen -17- eshte paraqitur e shkeputur sasija e energjise elektrike e shpenzuar nga nje person madhor gjate nje banje me dush, me uje te ngrohete dhe termostat te graduar ne temperatyre maksimale.

Nr.	Emertimi	Karakteristikat Teknike
1	Bojler:	Tip: "Ariston", Kapacitet: 80 Litra, Montim: Vertikal.
6	Fuqia efektive	$P_p = 1145 \text{ W}$, 50 Hz. Njefazore.
7	Tensioni i matur.	$U_p = 226 \text{ V}$.
8	Rryma e matur	$I_p = 4.91 \text{ A}$.
9	Temperatyra e mjedisit:	18 C°
10	Temperatyra e ujit te nxehte:	90°C°
11	Sasija e energjise se konsumuar	1.70 kWh.

Tabela-17- Konsumi per banje me dush i nje personi madhor

b) Analiza e konsumit specifik per ngrohje uji sanitar me bojler elektrik:

Konsumi i energjise elektrike per uje te ngrohete sanitar me bojler elektrik eshte funksion i disa faktoreve:

- a- I temperatyres ne te cilin eshte graduar termostati
- b- I temperatyres se mjedisit
- c- I rregjimit te punes se bojlerit

- Rregjim pune i pandërprere gjate gjithë muajit.

- Regjim pune diskret (me futje ne pune vetem kur perdoret per banje).

d- I menyres se perdorimit te ujit te ngrohte (ne se perdoret vetem per banje apo edhe per te plotesuar nevoja te tjera (larje enesh, larje duarsh etj.)

Ne studim nuk jane marre ne konsiderate te gjitha rregjimet e punes, dhe matjet nuk jane kryer per te gjitha keto regjime

Bojleret elektrik perdoren nga afro 100% e konsumatoreve urbane dhe rreth 60% e konsumatoreve rurale.

Kosumi i energjise elektrike per ndryshim te temperatyres se mjedisit nga dimri ne vere zvogelohet ne masen 20%.

Konsumi i energjise elektrike per ndryshim te gradimit te termostatit nga 60°C ne 90°C rritet me 40%.

Per te pasur nje konsum me te vogel energjie elektrike rekomandohet qe gjate stines se dimrit bojleri te hiqet nga puna per pauza mosperdorimi mbi 24 ore. Rekomandohet gjithashtu qe temperatyra e gradimit te termostatit te mos kaloje 70°C, nje gje e tille pervec kursimit te energjise elektrike i sherben pozitivisht jetegjatesise se bojlerit dhe aksesoreve te tije.

c) -Matja e konsumit specifik per larje teshash me maikine larese elektrike:

Matjet jane kryer duke e perdorur makinen larese ne dy regjime pune, ne regjimin me temperatyre te ujit te ngrohte 60°C dhe ne regjimin me temperatyre 90°C, per kapacitet te plote teshash per larje. Ne tabelat -18- dhe -19- jane paraqitur rezultatet perkatese

Tabela -18- **Makine Larese "Zannusi" t=60°C**

Nr.	Emertimi	Karakteristikat Teknike
1	Makine Larese Teshash:	Tip: "Zannusi", Kapacitet:5kg, 600 rrot/min.
2	Programi:	"B" Larje e plote me paralarje, Tujit=60 C°
6	Fuqia efektive	$P_p=1700-1900$ W, 50 Hz. njefazore.
7	Tensioni i matur.	$U_p= 228$ V.
8	Rryma e matur	$I_p= 7.9 - 9.2$ A.
9	Temperatyra e mjedisit:	18°C
10	Temperatyra e ujit te nxehte:	60°C
11	Energjia elektrike e shpenzuar gjate 24 oreve :	1.55 kWh.

Tabela -19- **Makine larese “Zannusi”, t=90°C**

Nr.	Emertimi	Karakteristikat Teknike
1	Makine Larese Teshash:	Tip: ”Zannusi”, Kapacitet:5kg, 600 rrot/min.
2	Programi:	”B” Larje e plote me paralarje, Tujit=90 C°
6	Fuqia efektive	$P_p=1700-1900$ W, 50 Hz. njefazore.
7	Tensioni i matur.	$U_p= 228$ V.
8	Rryma e matur	$I_p= 7.9 - 9.2$ A.
9	Temperatyra e mjedisit:	20°C
10	Temperatyra e ujit te nxehte:	90°C
11	Energjia elektrike e shpenzuar gjate 24 oreve :	1.98 kWh.

d) Analiza e konsumit specifik per larje teshash me makine larese elektrike:

Sikurse vihet re, rregjimet e punes te makines larese ndikojne drejtpersedrejt ne energjine elektrike te shpenzuar. Sikurse dihet makinat larese kane nje numur te madh programesh, por mendojme se investigimi per dy nga programet, prej te cilit njeri maksimal dhe tjetri mesatar, persa i perket konsumit te energjise elektrike, mendojme se sherbejne per te gjykuar per konsumin mesatar mujor nga perdorimi i tyre. Si konsum mesatar specifik per nje larje teshash me makine larese eshte pranuar nje konsum prej 1.8 kWh energji elektrike per cdo larje teshash me ngarkese normale 5kg.

e) Matja e konsumit specifik per tekniken ftohese ushqimore :

Per vleresimin e konsumit specifik te energjise elektrike per tekniken ftohese te produkteve ushqimore jane marre ne konsiderate dy tipe frigoriferesh familjar, perkatesisht me kapacitet ftohes 270 Litra dhe 110 Litra.

Tabela -20- **Frigorifer “Ariston”**

Nr.	Emertimi	Karakteristikat Teknike
1	Frigorifer Familjar:	Tip: ”Ariston”, Kapacitet:270Litra.
2	Programi:	Termostati i graduar ne poziconin ”4”
6	Fuqia efektive	$P_p=104$ W, 50 Hz. njefazore.
7	Tensioni i matur.	$U_p= 238$ V.

8	Rryma e matur	$I_p = 0.73 \text{ A.}, \cos\varphi = 0.65.$
9	Temperaturat e mjedisit:	20°C
11	Energjia elektrike e shpenzuar gjate 24 oreve :	0.95 kWh.

Tabela-21- Frigorifer “Obodin

Nr.	Emertimi	Karakteristikat Teknike
1	Frigorifer Familjar:	Tip: ”Obodin”, Kapacitet:110Litra.
2	Programi:	Termostati i graduar ne poziconin ”2”
6	Fuqia efektive	$P_p = 116 \text{ W}, 50 \text{ Hz.}$ njefazore.
7	Tensioni i matur.	$U_p = 238 \text{ V.}$
8	Rryma e matur	$I_p = 0.79 \text{ A.}, \cos\varphi = 0.69.$
9	Temperaturat e mjedisit:	20 C°
11	Energjia elektrike e shpenzuar gjate 24 oreve :	1.38 kWh.

Konsumi specifik eshte percaktuar per nje dite 24 oreshe.

Ne Tabelat -20- dhe -21- jane paraqitur rezultatet e matjeve perkatesisht per frigoriferin 270 Litra dhe per ate 110 Litra.

f) Analiza e konsumit specifik per tekniken ftohese ushqimore:

Egziston nje shumellojshmeri e madhe frigoriferesh si persa i perket volumit ftohes ashtu edhe persa i perket opsioneve te perdorimit. Energjia elektrike e shpenzuar varet jo vetem nga kapaciteti ftohes por edhe nga temperatura e mjedisit, nga kapaciteti i ngarkeses ushqimore per ruajtje, nga frekuenca e furnizimit me produkte ushqimore, frekuenca e perdorimit si dhe tipi i frigoriferit. Duke gjykuar se frigoriferi me kapacitet 270 Litra i prodhimit te kohes se sotme eshte me i perhapuri per perdorim familjar konsumi specifik i energjise elektrike duke u mbeshtetur ne matjet e kryera eshte pranuar mesatarisht 1.1 kWh/24 ore.

Aktualisht jane te pajisur me frigorifer reth 100% e familjeve ne zonen rurale dhe 95% e familjeve ne zonen rurale.

1.17. **Matja e konsumit specifik per tekniken televizive :**

Matjet e shpenzimit te energjise elektrike nga perdorimi i teknikes televizive jane kryer ne nje televizor me ekran 29", me top elektronik dhe ne nje televizor 25" gjithashtu me top elektronik gjate nje intervali pune prej 1 ore.

Ne Tabelat -22- dhe -23- jane permbledhur rezultatet e matjeve, perkatesisht per seicilin prej televizoreve.

Tabela -22- **Televizor "Sony", 29"**

Nr.	Emertimi	Karakteristikat Teknike
1	Televizor Familjar:	Tip: "Sony", 29", Me top elektronik.
6	Fuqia efektive	$P_p=90$ W, 50 Hz. njefazore.
7	Tensioni i matur.	$U_p=230$ V.
8	Rryma e matur	$I_p=0.41$ A., $\cos\varphi=0.97$.
9	Temperatyra e mjedisit:	20°C°
11	Energjia elektrike e shpenzuar gjate 1 ore :	0.09 kWh.

Tabela -23- **Televizor "Grundig", 25"**.

Nr.	Emertimi	Karakteristikat Teknike
1	Televizor Familjar:	Tip: "Gruding", 25", Me top elektronik.
6	Fuqia efektive	$P_p=113$ W, 50 Hz. njefazore.
7	Tensioni i matur.	$U_p=225$ V.
8	Rryma e matur	$I_p=0.53$ A., $\cos\varphi=0.95$.
9	Temperatyra e mjedisit:	20 C°
11	Energjia elektrike e shpenzuar gjate 1 ore :	0.11kWh.

a) Analiza e konsumit specifik per tekniken televizive:

Edhe aparatet marres televiziv perfaqsojne nje shumellojshmeri tipesh dhe principesh funksionimi. Pergjithesisht ata klasifikohen sipas madhesis se ekranit dhe parimit te funksionimit. Ne kohen e sotme prodhohen televizor klasik me top elektronik, me ekran me kristal likuid dhe me plazme. Ne investigimet e kryera jane trajtuar televizoret me top elektronik. Konsumi mesatar orar i nje televizori per qellimet e ketij studimi eshte pranuar 0.1 kWh

1.18. Matja e konsumit specifik per aksesoret elektroshtepiak :

Per kete kategori konsumatorësh jane kryer matje te konsumit te energjise elektrike gjate nje ore pune per hekurin elektrik per hekurosje, ndersa per furren me mikrovale, theksen e bukes, grillin elektrik (tost-in) dhe fshesen elektrike me vakuum jane matur parametrat elektrik te castit, mbasi rregjimet e punes per keto pajisje jane regjime me cikël te shkurter te perseritur dhe energjia e konsumuar prej tyre do te percaktohet sipas kohes mesatare mujore te perdorimit. Ne Tabelen -24- jane paraqitur rezultatet e matjeve per hekurin elektrik te hekurosjes.

Tabela -24- Hekur hekurosje "Tefal"

Nr.	Emertimi	Karakteristikat Teknike
1	Hekur elektrik hekurosje, familjar:	Tip: "Tefal". Gradimi: "Cotton"
6	Fuqia efektive	$P_p = 1810W$, 50 Hz. njefazore.
7	Tensioni i matur.	$U_p = 230V$.
8	Rryma e matur	$I_p = 7.83 A$.
9	Temperatyra e mjedisit:	$20^\circ C$
11	Energjia elektrike e shpenzuar gjate 1 ore :	0.68 kWh.

Parametrat e punes per furren me mikrovale paraqiten ne Tabelen -25-

Tabela -25- Furre me mikrovale "Moulinex" -

Nr.	Emertimi	Karakteristikat Teknike
1	Furre elektrike me mikrovale, familjar:e	Tip: "Moulinex".
6	Fuqia efektive	$P_p = 1440W$, 50 Hz. njefazore.
7	Tensioni i matur.	$U_p = 231V$.
8	Rryma e matur	$I_p = 6.14 A$.
9	Temperatyra e mjedisit:	$20^\circ C$
11	Energjia elektrike e shpenzuar gjate 15 minuta pune:	0.33 kWh.

Ne Tabelen -26- jane paraqitur parametrat e punes per theksen e bukes:

Tabela -26- Thekse buke "Philips"

Nr.	Emertimi	Karakteristikat Teknike
-----	----------	-------------------------

1	Thekse Buke elektrike familjare:	Tip: "Philips"
6	Fuqia efektive	$P_p = 1810W$, 50 Hz. njefazore.
7	Tensioni i matur.	$U_p = 230V$.
8	Rryma e matur	$I_p = 7.83 A$.
9	Temperatyra e mjedisit:	20 C°
11	Energjia elektrike e shpenzuar gjate 15 minutave pune:	0.33 kWh.

Ne Tabelen -27- jane paraqitur parametrat e punes per grillin elektrik:

Tabela -27- **Grill elektrik "Moulinex"**

Nr.	Emertimi	Karakteristikat Teknike
1	Grill elektrik familjar:	Tip: "Moulinex".
6	Fuqia efektive	$P_p = 1750W$, 50 Hz. njefazore.
7	Tensioni i matur.	$U_p = 230V$.
8	Rryma e matur	$I_p = 7.50 A$.
9	Temperatyra e mjedisit:	20 C°
11	Energjia elektrike e shpenzuar gjate 15 minutave pune:	0.32 kWh.

Tabela -28- **Fshese elektrike "Primotecq"**

Nr.	Emertimi	Karakteristikat Teknike
1	Fshese elektrike me vakuum,familjare:	Tip: "Primotecq" CST-500
6	Fuqia efektive	$P_p = 1840W$, 50 Hz. njefazore.
7	Tensioni i matur.	$U_p = 222V$.
8	Rryma e matur	$I_p = 8.41 A$.
9	Temperatyra e mjedisit:	20 C°
11	Energjia elektrike e shpenzuar gjate 15 minutave pune:	0.34 kWh.

Ne tabelen -28- jane paraqitur parametrat e punes per fshesen elektrike me vakum.

Ne Tabelen -29- jane paraqitur parametrat e punes per nje kompjuter tavoline (desktop), tip: "Dell" se bashku me ushqyesin e stabilizuar UPS. Duke qen se fuqia qe zhvillon kompjuteri gjate procesit te punes ndryshon nga regjimi i qetsise, vleresimi i energjise se shpenzuar eshte bere duke ju referuar nje ore pune ne kompjuter.

Tabela -29- **Personal kompjuter "Dell"**

Nr.	Emertimi	Karakteristikat Teknike
1	Kompjuter:	Tip: "Dell".
6	Fuqia efektive	$P_p = 115W$, 50 Hz. njefazore.
7	Tensioni i matur.	$U_p = 215V$.
8	Rryma e matur	$I_p = 0.56 A$. $\cos\varphi=0.96$
9	Temperatyra e mjedisit:	20 C°
11	Energjia elektrike e shpenzuar gjate 1 ore :	0.12 kWh.

Ne foton -13- eshte paraqitur nje pamje e matjes se konsumit specifik te energjise elektrike per nje kompjuter tip Dell.



Foto 13. Matja e konsumit specifik te kompjuterit "Dell"

Ne Tabelen -30- jane paraqitur parametrat e punes per nje kondicioner familjar i cili eshte vendosur te punoje ne regjim freskimi te mjedisit.

Tabela-30- **Kondicioner ajri "Mitsubishi "**

Nr.	Emertimi	Karakteristikat Teknike
1	Kondicioner familjar:	Tip: "Mitsubishi",SRK-288-HENF-L, 9000 BTU

6	Fuqia efektive	$P_p = 742\text{W}$, 50 Hz. njefazore.
7	Tensioni i matur.	$U_p = 225\text{V}$.
8	Rryma e matur	$I_p = 3.32\text{ A}$. $\text{Cos}\varphi = 0.98$
9	Gradimi temperatyres se mjedisit:	22 C°
11	Energjia elektrike e shpenzuar gjate 1 ore pune:	1.84 kWh.